FLETORJA ZYRTARE E REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË

Botim i Qendrës së Publikimeve Zyrtare

www.qpz.gov.al

Nr.104 6 gusht 2010

P Ë R M B A J T J A

		Faqe
Ligj nr.10 299 datë 15.7.2010	Për ratifikimin e konventës së Qendrës së Zbatimit të Ligjit në Europën Juglindore	5241
Ligj nr.10 300 datë 15.7.2010	Për ratifikimin e "Marrëveshjes ndërmjet shteteve palë në Traktatin e Atlantikut të Veriut për bashkëpunimin për informacionin atomik"	5260
Vendim i Kuvendit nr.47, datë 22.7.2010	Për emërimin e një anëtari të bordit të Institutit të Studimeve për Krimet dhe Pasojat e Komunizmit në Shqipëri	5271
Vendim i Kuvendit nr.48, datë 22.7.2010	Për emërimin e një anëtari të bordit të Institutit të Studimeve për Krimet dhe Pasojat e Komunizmit në Shqipëri	5272
Vendim i Kuvendit nr.49, datë 22.7.2010	Për emërimin e një anëtari të bordit të Institutit të Studimeve për Krimet dhe Pasojat e Komunizmit në Shqipëri	5272
Vendim i Kuvendit nr.50, datë 22.7.2010	Për emërimin e një anëtari të bordit të Institutit të Studimeve për Krimet dhe Pasojat e Komunizmit në Shqipëri	5273

LIGJ
Nr.10 299, datë 15.7.2010

PËR RATIFIKIMIN E KONVENTËS SË QENDRËS SË ZBATIMIT TË LIGJIT NË EUROPËN JUGLINDORE

Në mbështetje të neneve 78, 83 pika 1 dhe 121 të Kushtetutës, me propozimin e Këshillit të Ministrave,

KUVENDI
I REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË

VENDOSI:

Neni 1

Ratifikohet konventa e Qendrës së Zbatimit të Ligjit në Europën Juglindore.

Neni 2

Ky ligj hyn në fuqi 15 ditë pas botimit në Fletoren Zyrtare.

Shpallur me dekretin nr.6649, datë 21.7.2010 të Presidentit të Republikës së Shqipërisë, Bamir Topi

KONVENTA
E QENDRËS PËR ZBATIMIN E LIGJIT NË EUROPËN JUGLINDORE

Palët e kësaj Konvente, të cilat janë palë kontraktuese të Marrëveshjes për Bashkëpunimin për të Parandaluar dhe Luftuar Krimin Ndërkufitar, nënshkruar në Bukuresht, Rumani, më 26 maj 1999 (më poshtë referuar"Shtetet anëtare");

duke njohur vlerat dhe avantazhet e bashkëpunimit, strukturave dhe procedurave të krijuara dhe të zhvilluara nën kujdesin e iniciativës europiane për bashkëpunim në vendet e Europës Juglindore (SECI);

duke ditur që është përgjegjësi e të gjitha kombeve demokratike të krijojnë një shoqëri të mbështetur në liri, siguri dhe drejtësi;

duke respektuar Konventën Europiane për Mbrojtjen e të Drejtave dhe Lirive Themelore të Njeriut;

të ndërgjegjshme që kriminelët nuk respektojnë kufijtë dhe janë të prirur t'i shfrytëzojnë në dëm të barazisë dhe drejtësisë;

duke pasur parasysh që sipërmarrësit kriminelë prishin dhe korruptojnë ekonomitë e ligjshme, shoqëritë dhe shtetin e së drejtës, nëpërmjet tregjeve kriminale ndërkombëtare dhe nxitjes së aleancave tregtare të paligjshme ndërkombëtare;

duke konsideruar që është përgjegjësi e të gjitha qeverive në interes të shtetasve të tyre të angazhohen me masa të efektshme për të luftuar krimin dhe shkaqet e krimit duke respektuar plotësisht të drejtat themelore të individëve përfshirë këtu mbrojtjen e të dhënave personale;

duke pranuar rolin e rëndësishëm që ka shkëmbimi i efektshëm i informacionit midis agjencive të zbatimit të ligjit në parandalimin dhe luftën kundër të gjitha llojeve të krimit dhe krimeve të rënda, përfshirë këtu terrorizmin;

duke e konsideruar në interes të përbashkët kapitalizmin e avantazheve dhe mundësive të krijuara nga Qendra Rajonale SECI për të luftuar krimin ndërkombëtar (Qendra SECI) dhe duke paraprirë progresin e këtyre avantazheve dhe mundësive në një organizatë të re ndërkombëtare;

duke konsideruar traktatet ndërkombëtare në fushën e krimit ndërkufitar dhe bashkëpunimit për zbatimin e ligjit, si dhe *acquis* të BE-së për aq sa është e zbatueshme;

dhe sipas këtij qëllimi dhe interesi të përbashkët për të gjeneruar mekanizma të përforcuar për bashkëpunim të efektshëm ndërmjet agjencive kompetente të zbatimit të ligjit;

duke pranuar se Bashkimi Europian i ka caktuar Zyrës së Policisë Europiane (Europol) rolin drejtues si organ i zbatimit të ligjit të BE-së që mbështet luftën ndaj krimit të organizuar dhe të gjitha formave të tjera që shfaqin krimet e rënda dhe duke kërkuar të arrijnë kombinimet operacionale për përfitimin reciprok të SELEC dhe Europol;

bien dakord si më poshtë vijon:

TITULLI I
KRIJIMI, OBJEKTIVI DHE DETYRAT

Neni 1
Krijimi

Shtetet anëtare me anë të këtij dokumenti krijojnë Qendrën e Europës Juglindore për Zbatimin e Ligjit (tani e më poshtë "SELEC") që të shërbejë si një kuadër ligjor për bashkëpunimin midis autoriteteve të tyre kompetente për të përmbushur objektivat e SELEC.

Neni 2
Objektivi

Objektivi i SELEC, brenda kuadrit të bashkëpunimit midis autoriteteve kompetente, është të sigurojë mbështetje për shtetet anëtare dhe të forcojë bashkërendimin për të parandaluar dhe luftuar krimin, përfshirë këtu krimin e rëndë dhe të organizuar, kur këto krime përfshijnë ose duket se përfshijnë një element të veprimtarisë ndërkufitare.

Neni 3
Detyrat

Në përputhje me nenin 2, SELEC ka detyrat e mëposhtme:

a) të mbështesë investigimet dhe veprimtarinë e parandalimit të krimit në shtetet anëtare dhe në përputhje me këtë Konventë;

b) të lehtësojë shkëmbimin e informacionit dhe inteligjencës kriminale dhe kërkesave për asistencë operacionale;

c) të njoftojë dhe të informojë pikat kombëtare qendrore të shteteve anëtare për lidhjet ndërmjet të dyshuarve, kriminelëve ose krimeve që lidhen me mandatin e SELEC;

d) të mbledhë, të bashkojë, të analizojë, të përpunojë dhe të shpërndajë informacion dhe inteligjencën kriminale;

e) të sigurojë analizën strategjike dhe të bëjë vlerësimet e kërcënimeve që lidhen me objektivin e SELEC;

f) të krijojë, të realizojë dhe të ruajë një sistem të kompjuterizuar informacioni;

g) të veprojë si depozitari i praktikës së mirë për metodat dhe teknikat e zbatimit të ligjit dhe të promovojë të njëjtën gjë nëpërmjet trajnimeve dhe konferencave ndërkombëtare në dobi të shteteve anëtare;

h) të ndërmarrë detyra të tjera në përputhje me objektivin e kësaj Konvente, sipas një vendimi të Këshillit.

Neni 4
Përkufizime

Për qëllime të kësaj Konvente:

a) "Qendra SECI" nënkupton Qendrën Rajonale e Iniciativës për Bashkëpunim në Europën Juglindore për të luftuar krimin ndërkufitar, e krijuar me Marrëveshjen e Bashkëpunimit për të Parandaluar dhe Luftuar Krimin Ndërkufitar, të nënshkruar në Bukuresht, Rumani më 26 maj 1999;

b) "Zbatimi i ligjit" u referohet të gjitha veprimtarive që synojnë të parandalojnë dhe luftojnë krimin. Përfshihen, por jo vetëm, veprimtaria e doganave, policisë dhe rojeve kufitare, ku kjo veprimtari është pjesë e mandatit të SELEC;

c) "Autoriteti kompetent" nënkupton çdo organ publik që ekziston brenda një shteti anëtar ose partneri operacional, i cili është përgjegjës për zbatimin e ligjit sipas të drejtës kombëtare;

d) "Multiagjencia" nënkupton kombinimin e autoriteteve të ndryshme kompetente të përfshira në një sipërmarrje të vetme. Në mënyrë specifike në këtë Konventë, do të thotë kombinim i rojeve kufitare, policisë, doganave dhe autoriteteve të tjera kompetente;

e) "Krime të rënda" nënkupton sjellje që përbëjnë një vepër penale të dënueshme maksimumi me heqje lirie të paktën katër vjet ose një dënim edhe më i rëndë;

f)"Krim i organizuar" nënkupton çdo krim të kryer nga një grup i strukturuar prej tre ose më shumë personash që ekziston për një periudhë kohore dhe që vepron në bashkëpunim me qëllim që të kryejë një ose më shumë krime të rënda ose shkelje;

g) "Veprimtari ndërkufitare" nënkupton çdo veprimtari të paligjshme që kryhet ose synohet të kryhet në territorin e një ose më shumë shteteve anëtare;

h) "Person" nënkupton çdo person fizik ose juridik;

i) "Të dhëna personale" nënkupton të gjithë informacionin që lidhet me një person fizik të identifikuar ose të identifikueshëm ("subjekt i të dhënave");

j) "Përpunim" i të dhënave personale (përpunim) nënkupton çdo veprim apo tërësi veprimesh që kryhet mbi të dhënat personale, siç janë mbledhja, regjistrimi, organizimi, ruajtja, miratimi apo ndryshimi, nxjerrja, konsultimi, përdorimi, dhënia nëpërmjet transmetimit, shpërndarjes ose ndryshe vënia në dispozicion, grupimi ose kombinimi, bllokimi, fshirja ose asgjësimi;

k) "Nevoja për të ditur" nënkupton situatën kur një marrës i të dhënave ose informacionit kërkon të dijë për atë informacion për një nevojë specifike dhe të autorizuar, të përcaktuar në lidhje me pozicionin, rolin, detyrën apo funksionit e tij/saj;

l) "Pala e tretë" nënkupton një shtet ose organizatë ndërkombëtare ose organ që nuk është një shtet anëtar, partner operacional ose vëzhgues.

TITULLI II
STATUSI LIGJOR DHE ORGANIZIMI

Neni 5
Statusi ligjor

1. SELEC ka personalitet juridik ndërkombëtar.

2. SELEC ka në çdo shtet anëtar kapacitet kontraktual dhe ligjor sipas legjislacionit të atij shteti.

3. Në veçanti, SELEC ka kapacitetin:

a) të kontraktojë;

b) të blejë dhe shesë pronë të luajtshme dhe të paluajtshme;

c) të jetë palë në procedim ligjor.

Neni 6
Privilegje dhe imunitete

1. SELEC, përfaqësuesit e shteteve anëtare, oficerët ndërlidhës, Drejtori i Përgjithshëm, drejtorët, personeli i SELEC dhe përfaqësuesit e partnerëve operacionalë gëzojnë privilegje dhe imunitete të nevojshme për kryerjen e detyrave të tyre, në përputhje me një protokoll që do të përfundohet nga shtetet anëtare.

2. SELEC do të përfundojë një marrëveshje për selinë qendrore me shtetin pritës.

Neni 7
Organet e SELEC

Organet e SELEC do të jenë:

a) Këshilli;

b) Sekretariati.

Neni 8
Këshilli

1. Këshilli është organi më i lartë vendimmarrës i SELEC.

2. Këshilli përbëhet nga një përfaqësues i caktuar me zëvendësuesin e tij/saj nga çdo shtet anëtar. Çdo përfaqësues mund të mbështetet nga një delegacion.

3. Anëtarët e Këshillit janë nëpunës të lartë me autoritet për të vepruar në emër të shteteve të tyre. Kur një anëtar i Këshillit nuk mund të marrë pjesë në një takim, ai ose ajo zëvendësohet nga zëvendësi i tij/e saj.

4. Këshilli ka një kryetar të përzgjedhur me rotacion alfabetik vjetor midis shteteve anëtare.

5. Çdo shtet anëtar ka një votë në Këshill.

6. Këshilli mblidhet të paktën një herë në vit.

7. Këshilli ka detyrat e mëposhtme:

a) të miratojë planin strategjik të SELEC dhe planin vjetor të veprimit;

b) të miratojë çdo vit buxhetin e SELEC dhe të përcaktojë kontributet financiare të shteteve anëtare;

c) të miratojë detyra për SELEC të ndryshme nga ato që përcaktohen në nenin 3 të kësaj Konvente;

d) të zgjedhë dhe shkarkojë Drejtorin e Përgjithshëm dhe drejtorët dhe të përcaktojë afatet dhe kushtet e punësimit në përputhje me këtë Konventë;

e) të miratojë Manualin e Sigurisë;

f) të emërojë një oficer të mbrojtjes së të dhënave që do të jetë anëtar i personelit të SELEC;

g) të emërojë auditët e jashtëm financiarë për SELEC në përputhje me këtë Konventë;

h) të miratojë raportin vjetor të SELEC;

i) të autorizojë Drejtorin e Përgjithshëm që të negociojë marrëveshje, përfshirë këtu memorandume mirëkuptimi, me vendin pritës ose palët e treta, dhe nëse është e duhur, të përcaktojë pozicionet negociuese;

j) të miratojë përfundimin e marrëveshjeve, përfshirë këtu memorandumet e mirëkuptimit, me vendin pritës ose palët e treta;

k) të vendosë kriteret e pranimit për anëtarësime të reja në SELEC;

l) të miratojë kërkesat për anëtarësim nga shtetet dhe pranimin e tyre në SELEC;

m) të miratojë kërkesat nga çdo palë e tretë për t'u bërë vëzhgues ose partner operacional;

n) të miratojë rregulloren e tij të brendshme, si dhe rregullat e procedurës dhe rregullat e nevojshme për zbatimin e duhur të kësaj Konvente, përfshirë këtu udhëzimet për vëzhguesit;

o) të përmbushë detyrat e tjera të përcaktuara në këtë Konventë.

8. Këshilli, në kryerjen e detyrave të përmendura më sipër në shkronjat a, b, c, e, i, j, k, l, m dhe n të paragrafit (7), vendos me konsensusin e të gjitha shteteve anëtare. Në kryerjen e detyrave të tjera, vendimet e Këshillit duhet të merren me dy të tretat e shumicës së të gjitha shteteve anëtare, përveçse kur parashikohet ndryshe në këtë Konventë.

9. Këshilli mund të krijojë komisione dhe grupe pune për ta ndihmuar në punën e tij.

Neni 9
Sekretariati

1. Sekretariati përbëhet nga:

a) Drejtori i Përgjithshëm;

b) Drejtorët;

c) Personeli i SELEC.

2. Në kryerjen e detyrave të tyre, Drejtori i Përgjithshëm, drejtorët dhe personeli i SELEC nuk kërkojnë, nuk marrin apo nuk veprojnë sipas udhëzimeve të ndonjë qeverie apo ndonjë autoriteti tjetër të jashtëm për SELEC.

3. Çdo shtet anëtar merr përsipër të respektojë karakterin ekskluzivisht ndërkombëtar të përgjegjësive të Drejtorit të Përgjithshëm, drejtorëve dhe personelit të SELEC dhe nuk kërkon të ndikojë mbi ta për heqjen e përgjegjësive të tyre.

Neni 10
Drejtori i Përgjithshëm

1. SELEC drejtohet nga një Drejtor i Përgjithshëm që vepron si nëpunës i lartë ekzekutiv dhe përfaqësues ligjor.

2. Drejtori i Përgjithshëm zgjidhet për një mandat 4- vjeçar. Drejtori i Përgjithshëm mund të rizgjidhet vetëm një herë.

3. Drejtori i Përgjithshëm është shtetas i një prej shteteve anëtare dhe zgjidhet nga Këshilli pas një procedure të hapur dhe publike.

4. Drejtori i Përgjithshëm përgjigjet para Këshillit në lidhje me kryerjen e detyrave të tij/saj.

5. Drejtori i Përgjithshëm është përgjegjës për:

a) menaxhimin e efektshëm të SELEC;

b) përgatitjen dhe zbatimin e planit strategjik, planit vjetor të veprimit dhe buxhetit;

c) përgatitjen dhe dorëzimin e raporteve vjetore te Këshilli;

d) promovimin dhe zhvillimin e marrëdhënieve me shtetet anëtare dhe palët e treta;

e) negocimin dhe përfundimin e marrëveshjeve për pranimin e të ardhurave të tjera siç parashikohet në nenin 36 paragrafi (2);

f) hartimin dhe propozimin e rregullores së brendshme dhe rregullave të nevojshme për zbatimin e duhur të Konventës;

g) përfaqësimin e SELEC dhe interesave të tij;

h) caktimin e një drejtori që të veprojë në emër të tij në rast mungese apo pamundësie;

i) kryerjen e detyrave të tjera të nevojshme në përputhje me dispozitat e kësaj Konvente.

Neni 11
Drejtorët

1. Drejtori i Përgjithshëm ndihmohet nga një ose më shumë drejtorë. Këshilli përcakton numrin, funksionin dhe rolet e drejtorëve.

2. Drejtorët zgjidhen për një mandat 3- vjeçar. Drejtorët mund të rizgjidhen vetëm një herë.

3. Çdo drejtor është shtetas i një prej shteteve anëtare dhe zgjidhet nga Këshilli pas një procedure të hapur dhe publike.

4. Drejtorët përgjigjen para Drejtorit të Përgjithshëm për detyrat që iu ngarkohen atyre.

Neni 12
Personeli i SELEC

1. Personeli i SELEC përbëhet nga të gjithë personat që punojnë nën autoritetin dhe kontrollin e Drejtorit të Përgjithshëm dhe drejtorëve.

2. Personeli i SELEC përbëhet nga shtetas të shteteve anëtare duke pasur parasysh përfaqësimin e duhur të të gjitha shteteve anëtare.

3. Rregullat e personelit përfshijnë rregulla, parime dhe procedura që rregullojnë përzgjedhjen e personelit, rekrutimin e tyre, klasifikimin e pozicioneve, dhe funksionimin efikas të sekretariatit të SELEC për të arritur objektivin e kësaj Konvente.

Neni 13
Njësitë kombëtare

1. Njësitë kombëtare krijohen nga shtetet anëtare për qëllim të zbatimit të objektivit të kësaj Konvente.

2. Njësitë kombëtare përbëhen nga:

a) Oficerët ndërlidhës;

b) Pikat Kombëtare Qendrore.

Neni 14
Oficerët ndërlidhës

1. Për qëllime të bashkëpunimit policor dhe doganor, çdo shtet anëtar dërgon të paktën një oficer ndërlidhës që të punojë në zyrat qendrore të SELEC.

2. Oficerët ndërlidhës të SELEC punojnë sipas legjislacioneve kombëtare të shteteve anëtare që i caktojnë ata dhe përfaqësojnë interesat e atyre shteteve dhe të autoriteteve kompetente kombëtare në të njëjtën mënyrë. Megjithatë, puna e tyre rregullohet dhe nga kushtet e kësaj Konvente. Oficerët ndërlidhës së SELEC respektojnë rregulloren e brendshme dhe rregullat e SELEC.

3. Përpara emërimit, çdo oficer ndërlidhës i SELEC i nënshtrohet procedurës për kontroll sigurie sipas kërkesave kombëtare që mundësojnë akses në zbatimin e ligjit dhe/ose informacionin e klasifikuar.

4. Në rastet kur sjellja e një oficeri ndërlidhës nuk është e kënaqshme në lidhje me këtë Konventë, Drejtori i Përgjithshëm mund t'i raportojë respektivisht shtetit anëtar dërgues.

5. Oficerët ndërlidhës të SELEC nuk përfaqësojnë shtetin anëtar të tyre si të deleguar në Këshill.

6. Të gjitha kostot që lidhen me emërimin dhe dërgimin e oficerit ndërlidhës të SELEC financohen nga shteti anëtar. Megjithatë, SELEC nga buxheti i tij siguron akomodim në zyrë dhe pajisje të duhura dhe të arsyeshme që oficeri ndërlidhës të kryejë detyrat e tij/saj.

Neni 15
Pika kombëtare e kontaktit

1. Për të çuar përpara qëllimet e kësaj Konvente, shtetet anëtare krijojnë ose caktojnë një zyrë apo njësi multiagjencie, që të shërbejë si pikë kombëtare e kontaktit.

2. Pika kombëtare e kontaktit vepron si një pikë e vetme kontakti në shtetin anëtar për të komunikuar me SELEC, nëpërmjet oficerëve ndërlidhës të shtetit anëtar të caktuar.

3. Pika kombëtare e kontaktit ka personelin e nevojshëm dhe i sigurohen pajisjet e nevojshme, burimet dhe ambientet e duhura për të kryer detyrat e saj siç përcaktohen në këtë Konventë.

4. Pika kombëtare e kontaktit dhe personeli i saj drejtohen nga legjislacioni kombëtar, por kryejnë veprimtarinë e tyre duke iu referuar kësaj Konvente dhe në veçanti respektojnë parimet e mbrojtjes së të dhënave që përmban kjo Konventë.

Neni 16
Selia dhe gjuha zyrtare

1. SELEC do të vendoset në Bukuresht, Rumani.

2. Vendi pritës siguron pa pagesë ndërtesën dhe riparimet aktuale dhe kapitale në infrastrukturën e SELEC.

3. Gjuha zyrtare e SELEC është gjuha angleze.

TITULLI III
SISTEMI I INFORMACIONIT DHE SIGURIA E TË DHËNAVE

Neni 17
Sistemi i shkëmbimit të informacionit

1. Sipas fazave të parashtruara në këtë nen, SELEC krijon dhe ruan një sistem të kompjuterizuar informacioni për mbajtjen dhe përpunimin e të dhënave të nevojshme për kryerjen e detyrave të tij, siç përcakton neni 3. Ky sistem informacioni përfshin çdo pjesë të veçantë hardware-i ose bazë të dhënash të strukturuar në mënyrë të pavarur dhe të gjithë teknologjinë e informacionit nën kontrollin e SELEC.

2. SELEC kryen shkëmbimin e informacionit dhe operacioneve të përbashkëta ku SELEC nëpërmjet oficerëve ndërlidhës dhe përfaqësuesve të partnerëve operacionalë siguron të dhëna, përfshirë këtu të dhënat personale.

3. Në të gjitha fazat, përpunimi i të dhënave personale nga SELEC u nënshtrohet kufizimeve të vëna nga siguruesi i të dhënave dhe procedurave të mbrojtjes së të dhënave të zhvilluara për të përmbushur parimet e mbrojtjes së të dhënave të përcaktuara në këtë Konventë dhe kërkesa të tjera të zbatueshme të së drejtës kombëtare dhe marrëveshjeve ndërkombëtare dypalëshe ose shumëpalëshe. SELEC ruan të dhënat në mënyrë që të mund të përcaktohet se nga cili shtet anëtar, partner operacional, vëzhgues apo palë e tretë janë transmetuar të dhënat ose nëse ato janë rezultat i një analize nga SELEC.

4. Në masën dhe pas momentit që procedurat për mbrojtjen e të dhënave të duhura për detyrën janë vendosur dhe zbatuar, SELEC vepron më tej për të rritur aftësinë e tij për të ndihmuar shtetet anëtare dhe për të rritur bashkëpunimin mes tyre me qëllim parandalimin, zbulimin dhe luftën kundër krimit ndërkufitar, duke i ruajtur dhe indeksuar këto të dhëna personale për përdorim në investigime vijuese që përfshijnë SELEC dhe partnerët e tij operacionalë.

5. Rrjedhimisht, në masën dhe pas momentit që procedurat për mbrojtjen e të dhënave të duhura për detyrën janë vendosur dhe zbatuar, SELEC do të veprojë për të krijuar dhe ruajtur një ose më shumë bazë të dhënash që mund të përfshijnë të dhëna personale ose jo personale. Këto të dhëna mblidhen në kuadër të pjesëmarrjes së SELEC në çështje konkrete, si dhe jashtë kuadrit të çështjeve konkrete siç parashikohet nga shtetet anëtare, partnerët operacionalë, vëzhguesit dhe palët e treta dhe SELEC i analizon dhe përpunon këto të dhëna në përpjekje për të parandaluar, zbuluar dhe hetuar krimin e rëndë ndërkufitar.

6. Drejtori i Përgjithshëm ose çdo shtet anëtar mund t'i propozojë Këshillit që është e nevojshme të kalohet në fazën tjetër sipas këtij neni. Në vlerësimin e këtij propozimi, Këshilli konsultohet me Organin e Përbashkët Mbikëqyrës. Këshilli duhet të vendosë me konsensus nëse procedurat e mbrojtjes së të dhënave të duhura për detyrën janë zbatuar dhe nëse duhet kaluar në fazën tjetër siç përshkruhet në paragrafin (4) dhe (5).

7. Sistemet e informacionit të vëna në punë nga SELEC në asnjë rrethanë nuk duhet të lidhen me sisteme të tjera të përpunimit automatik, përveç sistemeve të përpunimit automatik të Njësive Kombëtare.

8. SELEC është përgjegjës dhe merr masat e nevojshme për kushtet e duhura të punës dhe zbatimin e sistemit të informacionit në aspektin teknik dhe operacional.

Neni 18

Përdorimi i sistemit të informacionit

1. Në krijimin dhe ruajtjen e sistemit të informacionit, SELEC dhe shtetet anëtare marrin masat e nevojshme dhe teknike të duhura dhe krijojnë mekanizma kontrolli për të siguruar integritetin dhe mjaftueshmërinë e të dhënave në sistemin e informacionit, për të parandaluar fshirjen aksidentale ose të paautorizuar, ndryshimet ose shpërndarjen dhe për të parandaluar aksesin e paautorizuar.

2. Për të kryer detyrat e tij, sistemi i informacionit të SELEC është i përdorshëm bazuar në "nevojën për të ditur" nga:

a) Pika kombëtare e kontaktit;

b) Oficerët ndërlidhës;

c) Drejtorët dhe personeli i SELEC të autorizuar nga Drejtori i Përgjithshëm;

d) Partnerë operacionalë të autorizuar sipas kushteve të marrëveshjeve të tyre përkatëse të bashkëpunimit.

3. Të dhënat në sistemin e informacionit të SELEC mund të futen vetëm nga:

a) Pika kombëtare e kontaktit;

b) Oficerët ndërlidhës;

c) Drejtorët dhe personeli i SELEC të autorizuar nga Drejtori i Përgjithshëm;

d) Partnerë operacionalë të autorizuar sipas kushteve të marrëveshjeve të tyre përkatëse të bashkëpunimit.

4. Aksesi ose futja e të dhënave në sistemin e informacionit të SELEC mund të bëhet vetëm nga personat që janë trajnuar në formën e duhur dhe që janë certifikuar, siç specifikohet në rregulloren e brendshme.

5. Të gjitha detajet në lidhje me futjen e të dhënave, kërkimin ose aksesin regjistrohen në format të kontrolluar. Këto detaje ruhen nga sistemi i informacionit të SELEC, në përputhje me rregullat e mbrojtjes së të dhënave siç përcaktohet në këtë Konventë.

Neni 19

Siguria e të dhënave

1. SELEC merr masat e nevojshme teknike dhe organizative për të siguruar zbatimin e kësaj Konvente në lidhje me sigurinë e të dhënave.

2. Në lidhje me përpunimin automatik të të dhënave në SELEC, çdo shtet anëtar dhe SELEC zbatojnë masat e caktuara:

a) për t'u mohuar personave të paautorizuar akses në pajisje të përpunimit të të dhënave që përdoren për përpunimin e të dhënave personale (kontrolli i aksesit në pajisje);

b) për të parandaluar leximin, kopjimin, ndryshimin apo heqjen e paautorizuar të materialeve me veçori të caktuara, që përfshijnë një variabël fizik, i cili mund të përdoret për të paraqitur të dhënat (kontrolli i materialeve me veçori të caktuara që përfshijnë një variabël fizik i cili mund të përdoret për të paraqitur të dhënat.);

c) për të parandaluar futjen e paautorizuar të të dhënave dhe inspektimin, ndryshimin apo fshirjen e paautorizuar të të dhënave personale të ruajtura (kontrolli i ruajtjes);

d) për të parandaluar përdorimin e sistemeve të përpunimit automatik të të dhënave nga persona të paautorizuar që përdorin pajisje të komunikimit të të dhënave (kontroll i përdoruesit);

e) për të siguruar që personat e autorizuar për përdorimin e sistemit të përpunimit automatik të të dhënave të kenë akses vetëm në të dhënat që i mbulon autorizimi i tyre për akses (kontroll i aksesit të të dhënave);

f) për të siguruar që është e mundur të verifikohet dhe të përcaktohet se tek cilat institucione mund të transferohen të dhënat personale duke përdorur pajisje të komunikimit të të dhënave (kontroll i komunikimit);

g) për të siguruar që është e mundur të verifikohet dhe të përcaktohet se cilat të dhëna personale janë hedhur në sistemin e përpunimit automatik të të dhënave dhe kur dhe nga kush janë hedhur këto të dhëna (kontrolli i hedhjes së të dhënave);

h) për të parandaluar leximin, kopjimin, ndryshimin apo fshirjen e paautorizuar të të dhënave personale gjatë transferimit të të dhënave personale ose gjatë transportimit të materialeve me veçori të caktuara që përfshijnë një variabël fizik, i cili mund të përdoret për të paraqitur të dhënat (kontroll i transportit);

i) për të siguruar që sistemet e instaluara, në rast ndërprerjeje, mund të rikuperohen menjëherë (riaftësimi);

j) për të siguruar që funksionet e sistemit veprojnë pa gabime, që paraqitja e gabimeve në funksione raportohet menjëherë (besueshmëria) dhe që të dhënat e ruajtura nuk mund të prishen nga një keqfunksionim i sistemit (integritet).

Neni 20
Informacioni i klasifikuar

1. I gjithë informacioni i përpunuar nga ose nëpërmjet SELEC, përveç të dhënave që janë shënuar shprehimisht ose janë qartësisht të dallueshme si informacion publik, i nënshtrohen një niveli bazë mbrojtjeje brenda organizatës së SELEC, si dhe shteteve anëtare. Të dhënat që i nënshtrohen vetëm nivelit bazë të mbrojtjes, nuk kërkojnë shënim specifik të një niveli sigurie të SELEC, por përcaktohen si të dhëna të SELEC.

2. SELEC dhe shtetet anëtare marrin masat e duhura për të mbrojtur informacionin e klasifikuar sipas kërkesës së konfidencialitetit të specifikuar nga pala që siguron të dhënat në bazë të kësaj Konvente.

3. Asnjë person nuk siguron akses në të dhënat e klasifikuara, përveçse kur ka kaluar kontrollin e sigurisë dhe pastërtisë nga qeveria kombëtare përkatëse, sipas legjislacionit të tij kombëtar. Autoriteti përkatës, sipas dispozitave kombëtare, njofton SELEC vetëm për rezultatet e kontrollit të sigurisë që janë të detyrueshme për SELEC.

4. Këshilli miraton një Manual Sigurie që përfshin, ndër të tjera, rregulla të detajuara për masat e sigurisë që duhet të zbatohen brenda organizimit të SELEC dhe një paketë sigurie që i korrespondon çdo niveli klasifikimi.

5. SELEC përdor nivelet e mëposhtme të klasifikimit: “i kufizuar”, “konfidencial”, “sekret” dhe “top sekret”.

6. Drejtori i Përgjithshëm mban përgjegjësi për zbatimin praktik të masave të sigurisë të parashtruara në Manualin e Sigurisë.

TITULLI IV
MBROJTJA E TË DHËNAVE PERSONALE

Neni 21
Të dhëna personale

1. Të dhënat personale që hidhen në sistemin e informacionit të SELEC lidhen me personat që, në përputhje me të drejtën kombëtare të shtetit anëtar përkatës, janë subjekte të një investigimi për një vepër penale në lidhje me të cilën SELEC është përgjegjës ose që janë dënuar për këtë vepër.

2. Të dhënat në lidhje me personat e përmendur në paragrafin (1) mund të përfshijnë vetëm detajet e mëposhtme:

a) mbiemër, emër vajzërie, emër të dhënë dhe çdo pseudonim (*alias*) ose emër të prezumuar;

b) datëlindje dhe vendlindje;

c) shtetësi;

d) gjini;

e) vendbanim, profesion dhe vendndodhje të personit në fjalë;

f) leje qarkullimi, dokumente identifikimi dhe të dhënat e pasaportës; dhe

g) kur është e nevojshme dhe e disponueshme, karakteristika të tjera që mund të ndihmojnë në identifikim, duke përfshirë çdo karakteristikë fizike specifike objektive që nuk ndryshon, dhe numër personal ose tjetër numër identifikimi.

3. Përveç të dhënave të përmendura në paragrafin (2), sistemi i informacionit të SELEC mund të përdoret gjithashtu për të përpunuar detajet e mëposhtme në lidhje me personat e përmendur në paragrafin (1):

a) veprën penale dhe kohën, vendin dhe mënyrën se si janë kryer:

b) mjete që u përdorën ose mund të përdoren për të kryer një vepër penale;

c) anëtarësinë e dyshuar në një organizatë kriminale;

d) dënime, kur lidhen me shkelje penale për të cilat SELEC është kompetent.

4. Sistemi i informacionit të SELEC mund të përfshijë gjithashtu:

a) të dhënat e përmendura në paragrafin (3) (a) dhe (b) kur ato nuk përmbajnë referenca për persona fizikë;

b) çdo të dhënë tjetër që është ose mund të jetë e përfshirë në çështje penale që nuk lidhen drejtpërdrejt me persona fizikë, duke përfshirë mallra, mjete transporti, biznese dhe çdo mjet teknik të përdorur për identifikimin e tyre.

Neni 22

Standardi i mbrojtjes së të dhënave personale

SELEC zbaton parimet për mbrojtjen e të dhënave personale të përpunuara nga SELEC duke pasur parasysh nivelin e mbrojtjes dhe praktikën administrative në shtetet anëtare dhe sipas standardeve dhe parimeve të Konventës së Këshillit të Europës për Mbrojtjen e Individëve të 28 janarit 1981 dhe të Rekomandimit nr. R (87) 15 të Komitetit të Ministrave të Këshillit të Europës të datës 17 shtator 1987. SELEC respekton këto parime për përpunimin e të dhënave personale, përfshirë këtu dhe të dhënat joautomatike të mbajtura në formën e skedarëve të të dhënave.

Neni 23

Parimet e mbrojtjes së të dhënave personale

1. Në zbatim të kësaj Konvente, SELEC zbaton parimet e mëposhtme në mbledhjen, përpunimin dhe përdorimin e të dhënave::

a) të dhënat personale të mbledhura dhe të përpunuara në sistemin e informacionit përdoren vetëm për qëllim të objektivave dhe detyrave të SELEC;

b) përpunimi i të dhënave personale duhet të jetë i drejtë dhe i ligjshëm;

c) përpunimi i të dhënave personale duhet të jetë i saktë, përkatës dhe jo i tepërt dhe në lidhje me qëllimet për të cilën u mblodhën fillimisht;

d) të dhënat duhet të jenë të sakta dhe të përditësuara dhe cilësia dhe integriteti i të dhënave personale përpunuar nga SELEC do të ruhet;

e) duhet të merren masat e duhura sigurie teknike dhe organizative ndaj riskut që mund të haset gjatë përpunimit të të dhënave;

f) SELEC përpunon të dhënat personale në mënyrë transparente, në përputhje me objektivin e tij të zbatimit të ligjit dhe detyrave;

g) subjekti i të dhënave ka akses në të dhënat e tij ose të saj personale të ruajtura nga SELEC, në përputhje me objektivin dhe detyrat e SELEC për zbatimin e ligjit;

h) subjekti i të dhënave ka të drejtën e duhur për korrigjim në lidhje me të dhënat e tij ose të saj personale që mbahen nga SELEC, në përputhje me objektivin dhe detyrat e SELEC për zbatimin e ligjit;

i) përpunimi i të dhënave personale nga SELEC i nënshtrohet mbikëqyrjes nga një Organ i Përbashkët Mbikëqyrës, i krijuar sipas kësaj Konvente.

2. Të dhënat personale që tregojnë racën ose origjinën etnike, bindjet politike, bindjet fetare ose të tjera, anëtarësimin në sindikata dhe të dhëna në lidhje me shëndetin ose jetën seksuale nuk mund të përpunohen nga SELEC nëse këto të dhëna nuk janë të nevojshme për investigim specifik

që përfshin SELEC dhe vetëm nëse e drejta kombëtare e palës transmetuese lejon transmetimin e këtyre të dhënave tek SELEC për përpunim. Ndalohet që të zgjidhet një grup i veçantë vetëm në bazë të të dhënave të shënuar në fjalinë e parë të këtij paragrafi.

Neni 24

Kufizime në aksesin për pjesë të veçanta të të dhënave personale

1. Një autoritet që siguron të dhëna personale mund të kufizojë aksesin në pjesë të veçanta të këtyre të dhënave nga shtetet e tjera anëtare ose partnerë operacionalë.

2. Shteti anëtar ose partneri operacional transmetues ose SELEC mund të bien dakord me marrësin e synuar për kufizimet mbi përdorimin e të dhënave dhe transmetimin te palët e treta. Këto kufizime duhet të përfshijnë masa për të siguruar përputhshmërinë me parimet e parashtruara në nenin 23 të kësaj Konvente.

Neni 25

Afatet kohore për ruajtjen dhe fshirjen e të dhënave personale

1. Të dhënat personale në sistemin e informacionit mbahen aq kohë sa është e nevojshme për kryerjen e detyrave të SELEC. Nevoja për ruajtjen e vazhdueshme do të rishikohet jo më vonë se tre vjet pas futjes së të dhënave personale. Rishikimi i të dhënave personale të ruajtura në sistemin e informacionit dhe heqja e tyre bëhet nga pala që hedh të dhënat.

2. Gjatë rishikimit, pala që hedh të dhënat e përmendur në paragrafin (1) mund të vendosë për ruajtjen e vazhdueshme të të dhënave personale deri në rishikimin tjetër që mund të bëhet pas një periudhe tjetër trevjeçare, nëse është akoma e nevojshme për qëllim të përpunimit. Nëse nuk merret vendim për ruajtjen e vazhdueshme të të dhënave personale, këto të dhëna personale fshihen automatikisht nga SELEC. SELEC informon automatikisht palët që hedhin të dhënat tre muaj përpara mbarimit të afateve kohore për rishikimin e ruajtjes së të dhënave personale.

Neni 26

Përpunimi i mëtejshëm

1. Asnjë dispozitë e kësaj Konvente nuk pengon apo ndalon autoritetet e zbatimit të ligjit që të bashkëpunojnë dhe shkëmbejnë të dhëna në raste dhe investigime konkrete, nëse ky bashkëpunim dhe shkëmbim të dhënash përfshin masa që sigurojnë përputhshmëri me parimet e përmendura në nenin 23 të kësaj Konvente. Megjithatë, transmetimi i të dhënave nuk mund të bëhet nëse përdorimi i të dhënave të transmetuara mund të shkelë të drejtat e njeriut ose parimet e shtetit të së drejtës.

2. Përpunimi i mëtejshëm i të dhënave personale për një qëllim të ndryshëm nga qëllimi për të cilin janë siguruar të dhënat personale lejohet për aq sa:

a) është në përputhje me qëllimin për të cilin janë përpunuar të dhënat nga SELEC; dhe

b) shteti anëtar ose partneri operacional që hedh të dhënat jep pëlqimin e tij; dhe

c) autoriteti përpunues është përgjegjës për parandalimin, investigimin, zbulimin ose ndjekjen e veprave penale brenda objektivit të SELEC.

3. Kalimi i të dhënave personale te palët e treta ose vëzhguesit mund të ndodhë vetëm duke marrë më parë miratimin e palës që fut të dhënat, në përputhje me legjislacionin e saj dhe në përputhje me vlerësimin e nivelit të duhur të mbrojtjes së të dhënave personale në palën e tretë ose vëzhguesin që merr të dhënat.

Neni 27

Oficeri i mbrojtjes së të dhënave

1. Këshilli emëron oficerin e mbrojtjes së të dhënave, që siguron përputhshmërinë me dispozitat e mbrojtjes së të dhënave të kësaj Konvente, sipas funksioneve të caktuara nga Këshilli. Në caktimin e këtyre funksioneve, Këshilli siguron që funksionet e oficerit të mbrojtjes së të

dhënave të jenë të përcaktuara kështu që të mos ndërhyjnë në veprimtarinë e SELEC në raste konkrete. Në kryerjen e detyrave të tij ose saj, oficeri për mbrojtjen e të dhënave do të veprojë në mënyrë të pavarur.

2. Oficeri i mbrojtjes së të dhënave, nën autoritetin e drejtpërdrejtë të Këshillit, kryen në veçanti detyrat e mëposhtme:

a) siguron, në mënyrë të pavarur, ligjshmërinë dhe përputhshmërinë me dispozitat e kësaj Konvente në lidhje me përpunimin e të dhënave personale;

b) siguron që të mbahet regjistrimi me shkrim i transmetimit dhe marrjes së të dhënave personale në përputhje me këtë Konventë;

c) siguron që subjektet e të dhënave të informohen për të drejtat e tyre sipas kësaj Konvente me kërkesë të tyre;

d) bashkëpunon me personelin e SELEC që është përgjegjës për procedurat, trajnimin dhe këshillimin për përpunimin e të dhënave;

e) bashkëpunon me Organin e Përbashkët Mbikëqyrës.

3. Në kryerjen e detyrave të përshkruara në paragrafin (2), oficeri i mbrojtjes së të dhënave, nuk merr asnjë udhëzim nga Drejtori i Përgjithshëm, drejtorët, një shtet anëtar apo ndonjë burim tjetër. Në kryerjen e këtyre detyrave, oficeri i mbrojtjes së të dhënave ka akses në të gjitha të dhënat e përpunuara nga SELEC dhe në të gjitha ambientet e SELEC.

4. Nëse oficeri i mbrojtjes së të dhënave gjykon që dispozitat e kësaj Konvente, në lidhje me përpunimin e të dhënave personale, nuk janë zbatuar, njofton Drejtorin e Përgjithshëm dhe Këshillin. Nëse Drejtori i Përgjithshëm nuk zgjidh brenda 60 ditëve mosrespektimin e përpunimit, oficeri i mbrojtjes së të dhënave njofton Këshillin, i cili bën të ditur marrjen e informacionit. Nëse Këshilli nuk zgjidh brenda një kohe të arsyeshme mosrespektimin e përpunimit, oficeri i mbrojtjes së të dhënave ia dërgon çështjen Organit të Përbashkët Mbikëqyrës.

5. Këshilli mund të përcaktojë detyra të tjera shtesë për oficerin e mbrojtjes së të dhënave. Rregulla të mëtejshme zbatuese në lidhje me oficerin e mbrojtjes së të dhënave, miratohen nga Këshilli.

Neni 28

Përgjegjësia për çështje të mbrojtjes së të dhënave personale

1. Përgjegjësia për të dhënat personale të përpunuara në SELEC, në veçanti në lidhje me ligjshmërinë e mbledhjes, transmetimit te SELEC dhe hedhjen e të dhënave personale, si dhe saktësinë e tyre, natyrën e tyre të përditësuar dhe verifikimin e afateve kohore të ruajtjes, qëndron te:

a) Shteti anëtar, partneri operacional, vëzhguesi ose pala e tretë që siguroi të dhënat personale;

b) SELEC në lidhje me të dhënat që rezultojnë nga analiza e kryer nga SELEC.

2. Gjithashtu, SELEC është përgjegjës për të gjitha të dhënat personale të përpunuara prej tij, nga momenti i përfshirjes së këtyre të dhënave në një nga skedarët e të dhënave automatike ose jo automatike. Të dhënat personale që i janë transmetuar SELEC, por që nuk janë përfshirë akoma në sistemin e informacionit të SELEC mbeten nën përgjegjësinë e mbrojtjes së të dhënave të palës që transmeton të dhënat. Megjithatë, SELEC është përgjegjës për të siguruar që deri në përfshirjen e këtyre të dhënave personale në një skedar të dhënash, ato të jenë të aksesueshme nga nëpunës të autorizuar të SELEC për qëllimin e përcaktimit nëse mund të përpunohen në SELEC ose nga nëpunës të autorizuar të palës që siguroi të dhënat.

Neni 29

Përgjegjësia për përpunim të paautorizuar ose të gabuar të të dhënave

1. Çdo shtet anëtar është përgjegjës, në përputhje me legjislacionin e tij kombëtar për çdo dëm që i është shkaktuar një individi si rezultat i gabimeve ligjore ose faktike në të dhënat

personale. Vetëm shteti anëtar, në territorin e të cilit ka ndodhur dëmi mund të jetë subjekt i një veprimi për kompensim për individin e dëmtuar. Një shtet anëtar nuk mund të justifikohet që një shtet tjetër anëtar ka transmetuar të dhëna të pasakta për të shmangur përgjegjësinë e tij sipas legjislacionit të tij kombëtar përballë një pale të dëmtuar.

2. Nëse këto gabime ligjore ose faktike kanë ndodhur si rezultat i të dhënave të komunikuara gabimisht ose mosrespektimit të detyrimeve të kësaj Konvente nga një ose më shumë shtete anëtare ose si rezultat i ruajtjes apo përpunimit të paautorizuara ose të pasaktë nga SELEC, shteti anëtar ose shtetet në fjalë ose SELEC, për këtë arsye, janë të detyruar t'i rimbursojnë, me kërkesë, shtetin anëtar që kompensoi individin e dëmtuar, shumat e paguara si kompensim, përveç se kur të dhënat në fjalë janë përdorur nga ky i fundit në shkelje të kësaj Konvente. Ky parim mund të zbatohet gjithashtu për partnerë operacionalë, nëse kjo parashikohet në marrëveshjen e tyre të bashkëpunimit me SELEC.

3. Çdo mosmarrëveshje ndërmjet shteteve anëtare që kompensuan individin e dëmtuar dhe SELEC ose një tjetër shtet anëtar mbi parimin ose shumën e rimbursimit i bëhet e ditur Këshillit, në përputhje me nenin 50.

Neni 30

Të drejtat e subjektit të të dhënave

1. Çdo person ka të drejtë, në intervale të arsyeshme, të marrë informacion nëse të dhënat personale që i përkasin atij ose asaj janë përpunuar nga SELEC, dhe të kërkojë t'i komunikohet ky informacion në një mënyrë të kuptueshme.

2. Çdo person që dëshiron të ushtrojë të drejtat e tij ose të saj sipas këtij neni mund të bëjë kërkesë falas te SELEC.

3. SELEC i përgjigjet kërkesës pa vonesë dhe në çdo rast brenda tre muajve pas marrjes së tij nga SELEC në përputhje me këtë nen.

4. Dhënia e informacionin në përgjigje të kërkesës, sipas paragrafit 1, do të refuzohet në rast se ky refuzim është i domosdoshëm:

a) të mundësojë që SELEC të përmbushë objektivat dhe detyrat e tij në mënyrën e duhur;

b) të mbrojë sigurinë dhe rendin publik në shtetet anëtare ose për të parandaluar krimin;

c) të mbrojë të drejtat dhe/ose liritë e personave të tretë; ose

d) të garantojë që çdo investigim kombëtar ose i përbashkët nuk do të rrezikohet.

5. Në vlerësimin e zbatueshmërisë së një përjashtimi në paragrafin (4), duhet të merren parasysh interesat e personit të përfshirë.

6. Përpara vendimit të tij për një përgjigje ndaj një kërkese, SELEC konsulton autoritetet kompetente të zbatimit të ligjit që sigurojnë të dhënat. SELEC refuzon të japë informacion nëse një ose më shumë autoritete kompetente për zbatimin e ligjit ose SELEC vendosin që kërkesa duhet të refuzohet sipas paragrafit (4). Autoriteti që vendos refuzimin njofton SELEC për arsyet e vendimit të tij.

7. Nëse refuzohet sigurimi i informacionit në përgjigje të një kërkese sipas paragrafit (1), SELEC njofton personin e interesuar që kërkesa e tij ose e saj është shqyrtuar dhe refuzuar sipas kësaj Konvente, pa dhënë informacion që mund t'i zbulojë atij ose asaj nëse të dhënat personale në lidhje me të janë përpunuar apo jo nga SELEC. Arsyet për një refuzim regjistrohen nga SELEC.

Neni 31

Korrigjimi dhe fshirja e të dhënave

1. Çdo subjekt të dhënash ka të drejtë t'i kërkojë SELEC me shkrim të korrigjojë ose të fshijë të dhëna të pasakta në lidhje me të. Nëse, në bazë të ushtrimit të kësaj të drejte, ose në mënyrë tjetër, duket që të dhënat e mbajtura nga SELEC, të cilat i janë komunikuar nga palë të treta ose që janë rezultat i analizës së tij, janë të pasakta ose që hedhja ose ruajtja e tyre bie në kundërshtim me këtë Konventë, SELEC i korrigjon ose i fshin këto të dhëna.

2. Nëse të dhëna të pasakta janë transmetuar me mjete të tjera të papërshtatshme ose nëse gabimet te të dhënat e siguruara nga shtetet anëtare ose partnerë operacionalë janë për shkak të transmetimit të gabuar ose janë transmetuar në shkelje të dispozitave të kësaj Konvente ose nëse rezultojnë nga hedhja, marrja ose ruajtja e tyre në mënyrë të pasaktë, ose në shkelje të dispozitave të kësaj Konvente nga SELEC, SELEC është i detyruar t'i korrigjojë ose t'i fshijë të dhënat në bashkëpunim me shtetet anëtare dhe partnerët operacionalë të përfshirë.

3. Në rastet e përmendura në paragrafët (1) dhe (2), shtetet anëtare ose partnerët operacionalë që kanë marrë të dhënat njoftohen më tej në lidhje me to. Shtetet anëtare ose partnerët operacionalë marrës, gjithashtu korrigjojnë ose fshijnë këto të dhëna sipas rregullave të zbatueshme.

4. Përveçse siç parashikohet në nenin 30, paragrafët (4) dhe (5), SELEC njofton subjektin e të dhënave me shkrim dhe pa vonesë dhe në çdo rast brenda tre muajve që të dhënat në lidhje me të janë korrigjuar ose fshirë.

Neni 32
Ankimimi

1. Në përgjigjen e tij ndaj një kërkese për kontroll, për akses në të dhëna, ose një kërkese për korrigjim dhe fshirje të të dhënave, SELEC bën me dije subjektin e të dhënave që ai ose ajo ka të drejtë të ankimojë tek Organi i Përbashkët Mbikëqyrës dhe për afatin kohor për këtë ankimim.

2. Çdo subjekt të dhënash ka të drejtën të ankimojë tek Organi i Përbashkët Mbikëqyrës, nëse ai ose ajo nuk është i/e kënaqur me përgjigjen e SELEC ndaj një kërkese ose nëse nuk ka marrë përgjigje për kërkesën brenda afateve kohore të përcaktuara në nenin 30 ose 31. Ky ankimim duhet të bëhet brenda 30 ditëve nga data e marrjes së përgjigjes ose mbarimit të afateve kohore, të përcaktuara në nenin 30 ose 31.

3. Organi i Përbashkët Mbikëqyrës shqyrton dhe vendos për ankimimin në takimin e tij të radhës. Vendimi i Organit të Përbashkët Mbikëqyrës për një ankimim është përfundimtar dhe i detyrueshëm për të gjitha palët në ankimim.

4. Nëse ankimimi lidhet me një përgjigje ndaj një kërkese të përmendur në nenin 30 ose 31, Organi i Përbashkët Mbikëqyrës konsultohet me autoritetet kompetente për mbrojtjen e të dhënave në shtetin anëtar ose partnerin operacional që ishte burimi i të dhënave ose shtetet anëtare ose partnerët operacionalë të përfshirë drejtpërdrejt.

5. Në rast se ankimimi lidhet me vendimin e përmendur në nenin 30 ose 31 që bazohet në një kundërshtim sipas nenit 30, paragrafi (4), nga SELEC, një shtet anëtar ose partner operacional, Organi i Përbashkët Mbikëqyrës është në gjendje vetëm t'i rrëzojë këto kundërshtime me konsensus, pasi të ketë dëgjuar SELEC dhe shtetet anëtare ose partnerët operacionalë të përfshirë. Nëse nuk arrihet konsensusi, Organi i Përbashkët Mbikëqyrës i bën të ditur refuzimin kërkuesit, pa dhënë informacion të mëtejshëm që mund të tregojë ekzistencën e të dhënave personale për kërkuesin.

Neni 33
Mbikëqyrja kombëtare

1. Shtetet anëtare sigurojnë mbikëqyrje kombëtare të pavarur, duke caktuar një autoritet, në përputhje me të drejtën e saj kombëtare, mbi aktivitetet sipas kësaj Konvente lidhur me çështje për mbrojtjen e informacionit personal, dhe duke marrë parasysh standardet dhe parimet ndërkombëtare të mbrojtjes së të dhënave personale caktuar nga Këshilli i Europës.

2. Pa cenuar nenin 29, shtetet anëtare sigurojnë për të drejtën e çdo personi, pavarësisht kombësisë ose vendbanimit të tij ose saj, mjetin juridik për çdo shkelje të të drejtave që i garantohen atij ose asaj nga e drejta kombëtare e aplikueshme për përpunimin e të dhënave referuese.

3. SELEC do të marrë masat e nevojshme për të lehtësuar këtë mbikëqyrje kombëtare, duke përfshirë këtu edhe sigurimin e së drejtës për hyrje dhe përdorim në ambientet e aplikueshme të oficerëve ndërlidhës.

4. Shtetet anëtare informojnë Organin e Përbashkët Mbikëqyrës për çdo konkluzion, lidhur me mbrojtjen e të dhënave personale që kanë të bëjnë me SELEC që rezultojnë nga kjo mbikëqyrje.

Neni 34
Organ i Përbashkët Mbikëqyrës

1. Organi i Përbashkët Mbikëqyrës i pavarur krijohet për të dëgjuar ankimimet sipas nenit 32 dhe për të rishikuar procedurat dhe praktikat në SELEC, me qëllim që të sigurojë që ato respektojnë dispozitat e kësaj Konvente për mbrojtjen e të dhënave. Organi i Përbashkët Mbikëqyrës përbëhet nga një përfaqësues nga çdo shtet anëtar që është i pavarur në lidhje me çështje të mbrojtjes së të dhënave personale sipas së drejtës kombëtare. Organi i Përbashkët Mbikëqyrës përcakton rregulloren e tij të brendshme. Në kryerjen e detyrave të tij, anëtarët e Organit të Përbashkët Mbikëqyrës nuk marrin udhëzime nga ndonjë organ tjetër.

2. Organi i Përbashkët Mbikëqyrës bën rishikime të rregullta të paktën një herë në vit.

3. SELEC ndihmon Organin e Përbashkët Mbikëqyrës për kryerjen e detyrave të këtij të fundit. Për këtë qëllim, në veçanti:

a) siguron informacionin e kërkuar nga Organi i Përbashkët i Mbikëqyrjes, mundëson akses në të gjitha dokumentet dhe skedarët e shkresave, si dhe në të dhënat e ruajtura në skedarët e tij të të dhënave;

b) mundëson akses të lirë për Organin e Përbashkët Mbikëqyrës në çdo kohë në ambientet e tij;

c) zbaton vendimet e Organit të Përbashkët të Mbikëqyrjes për ankimimet.

4. Nëse Organi i Përbashkët Mbikëqyrës identifikon shkelje të dispozitave të kësaj Konvente për ruajtjen, përpunimin ose përdorimin e të dhënave personale, ai e dërgon çështjen në vëmendje të Drejtorit të Përgjithshëm dhe i kërkon atij të përgjigjet brenda një afati kohor të specifikuar nga Organi i Përbashkët Mbikëqyrës. Drejtori i Përgjithshëm e mban Këshillin të informuar për gjithë procedurën. Nëse nuk është i kënaqur me përgjigjen e dhënë nga Drejtori i Përgjithshëm me kërkesën e tij, Organi i Përbashkët Mbikëqyrës ia dërgon çështjen Këshillit.

5. Organi i Përbashkët Mbikëqyrës njofton Drejtorin e Përgjithshëm dhe Këshillin për rishikimet e tij dhe bën rekomandime të nevojshme në lidhje me procedurat dhe praktikat e mbrojtjes së të dhënave. Drejtori i Përgjithshëm dhe Këshilli konsiderojnë këto rekomandime dhe marrin të gjitha hapat e duhura për të korrigjuar problemet me procedurat dhe praktikat.

6. Organi i Përbashkët Mbikëqyrës do të hartojë dhe do të bëjë publike raportet në intervale kohore të rregullta.

TITULLI V
DISPOZITA FINANCIARE

Neni 35
Buxheti

1. Buxheti i SELEC përcaktohet në bazë vjetore. Viti financiar fillon nga 1 janari deri në 31 dhjetor.

2. Buxheti parashtron të ardhurat totale dhe shpenzimet totale për vitin. Buxheti balancohet me të ardhura totale vjetore, gjithmonë duke mbuluar shpenzimet totale vjetore.

3. Këshilli shqyrton dhe miraton buxhetin deri më 31 maj të çdo viti. Buxheti mund të rishikohet nga Këshilli.

4. Një plan financiar pesëvjeçar shqyrtohet dhe miratohet dhe mund të rishikohet së bashku me buxhetin vjetor.

Neni 36
Të ardhurat

1. Buxheti financohet nga kontributet e shteteve anëtare dhe të ardhura të tjera.

2. Të ardhura të tjera mund të përfshijnë donacione, subvencione ose fonde të tjera nga qeveritë kombëtare, organizatat ndërkombëtare ose burimeve të tjera publike dhe, në varësi të miratimit të Këshillit, burime private.

3. Mospërmbushja e detyrimeve financiare nga çdo shtet anëtar i paraqitet Këshillit për shqyrtim.

Neni 37
Auditi i jashtëm financiar

Procesverbalet financiare të SELEC, duke përfshirë llogaritë e krijuara sipas buxhetit që tregojnë të ardhura dhe shpenzime, dhe bilanci që tregon aktivet dhe pasivet e SELEC, i nënshtrohen auditit të jashtëm financiar.

Neni 38
Rregulla dhe rregullore financiare

Rregullat dhe rregulloret financiare shqyrtohen dhe miratohen nga Këshilli.

TITULLI VI
PJESËMARRJA

Neni 39
Anëtarësia

Anëtarët e SELEC janë palë në këtë Konventë.

Neni 40
Pranimi

1. SELEC është i hapur për pranim për çdo shtet që ka interes të veçantë në bashkëpunimin për zbatimin e ligjit në rajonin e Europës Juglindore dhe që aplikon për anëtarësim, pranon objektivin dhe detyrat e SELEC siç parashtrohen në këtë Konventë dhe plotëson kriteret e përcaktuara nga Këshilli.

2. Aplikimet për anëtarësim i paraqiten Këshillit për shqyrtim dhe miratim. Sapo merret miratimi, Këshilli fton shtetin kërkues që të aderojë në këtë Konventë sipas nenit 45.

Neni 41
Statusi i partnerit operacional

1. Statusi i partnerit operacional në SELEC është i hapur sipas kërkesës për çdo shtet ose organizatë ndërkombëtare ose organ që shpreh gatishmërinë për të bashkëpunuar me SELEC, pranon të ofrojë mbështetje për SELEC dhe lidh marrëveshje bashkëpunimi me SELEC.

2. Pasi Këshilli vendos që një kërkues plotëson kushtet e kërkuara për fillimin e negociatave për statusin e partnerit operacional, Drejtori i Përgjithshëm negocion marrëveshjen e bashkëpunimit me atë kërkues.

3. Marrëveshja e bashkëpunimit parashtron, ndër të tjera, rregullat e duhura për mbrojtjen e të dhënave, marrëdhëniet financiare dhe zgjidhjen e mosmarrëveshjeve ndërmjet SELEC dhe partnerit operacional. Sapo projektteksti i marrëveshjes së bashkëpunimit miratohet nga Këshilli, ai nënshkruhet nga Drejtori i Përgjithshëm në emër të SELEC.

4. Statusi i partnerit operacional mund të pezullohet ose të përfundojë me vendim të Këshillit.

5. Një partner operacional mund të dërgojë, me shpenzimet e veta, përfaqësuesit në selinë e SELEC për qëllime të zbatimit të marrëveshjes së bashkëpunimit.

Neni 42
Statusi i vëzhguesit

1. Statusi i vëzhguesit në SELEC është i hapur sipas kërkesës për çdo shtet ose organizatë ndërkombëtare ose organ që shpreh gatishmërinë për të bashkëpunuar me dhe për të kontribuar për SELEC.

2. Vëzhguesit mund të ftohen të marrin pjesë në takime të Këshillit. Statusi i vëzhguesit nuk jep të drejtën për të marrë pjesë në veprimtari operacionale ose për të shkëmbyer informacion ose të dhëna personale ose të klasifikuara.

3. Statusi i vëzhguesit mund të jepet, pezullohet ose përfundojë me vendim të Këshillit, të miratuar në përputhje me kushtet e parashtruara në udhëzimet për vëzhguesit.

Neni 43
Marrëdhëniet me organizata dhe institucione të zbatimit të ligjit

1. SELEC do të bëjë përpjekje për të krijuar marrëdhënie përfitimi reciproke me organizata europiane të zbatimit të ligjit dhe organizata ose organe të tjerë ndërkombëtare, ndër të tjera Europol, Interpol dhe Organizata Botërore e Doganave, me qëllim për të rritur bashkëpunimin e efektshëm të agjencive të zbatimit të ligjit.

2. Në krijimin e marrëdhënieve të saj me Europol dhe gjithashtu para mbylljes së një marrëveshjeje bashkëpunimi, SELEC mund të përdorë ndër të tjera, kapacitetin strategjik të analizave operacionale të Europol, nëse Europol ofron këtë kapacitet. Lidhur me këtë të fundit, SELEC dhe Europol mund të bien dakord për të punësuar një ose më shumë përfaqësues në selitë qendrore të SELEC dhe Europol.

TITULLI VII
PËRGJEGJËSIA

Neni 44
Përgjegjësia

1. Çdo përgjegjësi kontraktuale që përfshin SELEC rregullohet me ligj të zbatueshëm në shtetin ku kontrata ka fuqi, përveçse kur kontrata përcakton ndryshe.

2. Në rast të përgjegjësive jokontraktuale, SELEC është i detyruar të riparojë çdo dëm të shkaktuar nga gabimi i organeve të tij, Drejtori i Përgjithshëm, drejtorët dhe personeli i SELEC në kryerjen e detyrave të tyre.

TITULLI VIII
DISPOZITA PËRFUNDIMTARE

Neni 45
Nënshkrimi, ratifikimi, pranimi, miratimi dhe aderimi

1. Kjo Konventë është e hapur për nënshkrim nga shtetet palë të Marrëveshjes për Bashkëpunimin për të Parandaluar dhe Luftuar Krimin Ndërkufitar, të nënshkruar në Bukuresht, Rumani, më 26 maj 1999.

2. Kjo Konventë i nënshtrohet ratifikimit, pranimit ose miratimit nga shtetet nënshkruese në përputhje me kërkesat e tyre përkatëse ligjore.

3. Kjo Konventë është e hapur për aderim për çdo shtet tjetër në përputhje me dispozitat e kësaj Konvente.

4. Dokumente të ratifikimit, pranimit, miratimit ose aderimit depozitohen te Depozitari.

5. Çdo shtet anëtar njofton sekretariatin e autoriteteve të tij kompetente kombëtare për depozitimin e instrumentit të tij të ratifikimit, pranimit, miratimit, ose aderimit.

Neni 46
Hyrja në fuqi

1. Kjo Konventë hyn në fuqi ditën e gjashtëdhjetë pas datës së depozitimit të instrumenteve të ratifikimit, pranimit ose miratimit nga nëntë shtete palë të Marrëveshjes për Bashkëpunimin për të Parandaluar dhe Luftuar Krimin Ndërkufitar, të nënshkruar në Bukuresht, Rumani, më 26 maj 1999.

2. Për çdo shtet që ratifikon, pranon, miraton ose aderon në këtë Konventë pas datës së hyrjes në fuqi të saj, siç parashikohet në paragrafin (1), kjo Konventë në lidhje me atë shtet hyn në fuqi në datën e depozitimit të instrumentit përkatës nga shteti.

Neni 47
Ndryshimet

1. Kjo Konventë mund të ndryshohet me propozim të çdo shteti anëtar.

2. Çdo propozim i tillë u komunikohet, nga Drejtori i Përgjithshëm, shteteve anëtare të paktën gjashtë muaj përpara paraqitjes në Këshill për shqyrtim dhe miratim.

3. Ndryshime të kësaj Konvente të miratuara sipas paragrafit (2) i nënshtrohen ratifikimit, pranimit ose miratimit nga shtetet anëtare dhe hyjnë në fuqi sipas procedurave të parashtruara në nenin 46.

Neni 48
Rezervat

Për këtë Konventë nuk ka rezerva.

Neni 49
Dispozita kalimtare

1. Me hyrjen në fuqi të kësaj Konvente, Marrëveshja për Bashkëpunimin për të Parandaluar dhe Luftuar Krimin Ndërkufitar e nënshkruar në Bukuresht, Rumani, më 26 maj 1999, nuk do të jetë më në fuqi.

2. Të gjitha të drejtat, detyrimet dhe pronat që i përkasin qendrës SECI i transferohen SELEC në datën e hyrjes në fuqi të kësaj Konvente.

3. Të gjithë vëzhguesit e qendrës SECI kanë të drejtë të bëhen vëzhgues të SELEC duke e deklaruar këtë synim zyrtarisht te Drejtori i Përgjithshëm.

4. Vëzhguesit e qendrës SECI që dëshirojnë të bëhen partnerë operacionalë në SELEC aplikojnë për këtë status.

5. Të gjithë Këshilltarët e Përhershëm në Komitetin e Përbashkët të Bashkëpunimit të Qendrës SECI, në bazë të Marrëveshjes SECI kanë të drejtën të bëhen vëzhgues të SELEC duke e deklaruar këtë synim zyrtarisht te Drejtori i Përgjithshëm.

6. Marrëveshja e Selisë Qendrore ndërmjet Rumanisë dhe Qendrës Rajonale të Iniciativës së Europës Juglindore për Bashkëpunim për të Luftuar Krimin Ndërkufitar nënshkruar në Bukuresht, Rumani, më 2 tetor 2000 mbetet në fuqi deri sa të hyjë në fuqi marrëveshja për selinë ndërmjet SELEC dhe vendit pritës e përmendur në nenin 6, paragrafi (2).

Neni 50
Zgjidhja e mosmarrëveshjeve

Në rast të një mosmarrëveshjeje ndërmjet dy ose më shumë shteteve anëtare ose ndërmjet shtetit anëtar dhe SELEC, në lidhje me interpretimin ose zbatimin e kësaj Konvente, palët e përfshira kërkojnë një zgjidhje nëpërmjet konsultimit dhe negocimit reciprok. Nëse këto konsultime dhe negocime nuk zgjidhin mosmarrëveshjet brenda gjashtë muajve, palët ia paraqesin mosmarrëveshjet Këshillit për shqyrtim dhe veprimin e duhur.

Neni 51
Tërheqja

1. Çdo shtet anëtar mund të tërhiqet nga kjo Konventë në çdo kohë me njoftim me shkrim te sekretariati dhe Depozitari, që më pas i dërgon një kopje të certifikuar të këtij njoftimi çdo shteti anëtar.

2. Tërheqja hyn në fuqi tre muaj pas datës së marrjes së njoftimit nga Depozitari. Veprimtaritë ose procedurat ekzistuese ose në proces në kohën e tërheqjes, pavarësisht kësaj, përfundohen në përputhje me dispozitat e kësaj Konvente.

3. Në lidhje me detyrimet financiare, kjo tërheqje hyn në fuqi në fund të vitit financiar në të cilin është njoftuar.

4. Një shtet anëtar që tërhiqet vazhdon të respektojë dispozitat e kësaj Konvente në lidhje me mbrojtjen e të dhënave të shkëmbyera sipas kësaj Konvente.

Neni 52
Depozitari

1. Qeveria e Rumanisë vepron si Depozitar i kësaj Konvente.

2. Depozitari i dërgon një kopje të certifikuar të origjinalit sekretariatit të Kombeve të Bashkuara për regjistrimin dhe publikimin në përputhje me nenin 102 të Kartës së Kombeve të Bashkuara.

Origjinali i kësaj Konvente në një kopje të vetme në anglisht depozitohet te Depozitari që i dërgon një kopje të certifikuar çdo shteti anëtar.

Në dëshmi të kësaj, palët nënshkruese, të autorizuara sipas rregullit nga qeveritë e tyre përkatëse, e kanë nënshkruar këtë Konventë.

Bërë më_____në_____.

LIGJ
Nr.10 300, datë 15.7.2010

PËR RATIFIKIMIN E "MARRËVESHJES NDËRMJET SHTETEVE PALË NË TRAKTATIN E ATLANTIKUT TË VERIUT PËR BASHKËPUNIMIN PËR INFORMACIONIN ATOMIK"

Në mbështetje të neneve 78, 83 pika 1 dhe 121 të Kushtetutës, me propozimin e Këshillit të Ministrave,

KUVENDI
I REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË

VENDOSI:

Neni 1

Ratifikohet "Marrëveshja ndërmjet shteteve palë në Traktatin e Atlantikut të Veriut për bashkëpunimin për informacionin atomik", si dhe aneksi teknik e i sigurisë së saj, bërë në Paris më 18 qershor 1964.

Neni 2

Ky ligj hyn në fuqi 15 ditë pas botimit në Fletoren Zyrtare.

Shpallur me dekretin nr.6650, datë 21.7.2010 të Presidentit të Republikës së Shqipërisë, Bamir Topi

KËSHILLI I ATLANTIKUT TË VERIUT

Kopja N X(88)1583

NATO
Dokument
C-M(64)39

PROJEKTMARRËVESHJE PËR BASHKËPUNIMIN
NË LIDHJE ME INFORMACIONIN ATOMIK
RAPORT NGA GRUPI I PUNËS

1. Në mbledhjen e tij të datës 31 korrik 1963(1), Këshilli shqyrtoi një shënim të Sekretarit të Përgjithshëm, të cilit i ishte bashkëngjitur një memorandum dhe një projektmarrëveshje e re për bashkëpunimin në lidhje me informacionin atomik të paraqitur nga delegacioni i Shteteve të Bashkuara. Këshilli ra dakord të ngrejë një grup pune për ta shqyrtuar këtë projektmarrëveshje dhe t'i paraqesë propozimet në Këshill.

2. Grupi i punës pas kësaj paraqet projektin e një marrëveshjeje të përpiluar duke marrë parasysh komentet e bëra nga delegacionet e ndryshme mbi propozimet fillestare të Shteteve të Bashkuara.

3. Sugjerohet që për lidhjen e Marrëveshjes, duhet të ndiqet një procedurë e ngjashme me atë të miratuar në vitin 1955 për marrëveshjen e mëparshme. Hapi i parë sipas kësaj procedure do të ishte që Këshilli të pranojnë një rezolutë, sipas tekstit të mëposhtëm.

"Këshilli i Atlantikut të Veriut:

duke vënë re që grupi i punës, që u mblodh për të shqyrtuar projektmarrëveshjen e re për bashkëpunimin në lidhje me informacionin atomik të propozuar nga Shtetet e Bashkuara palëve të tjera në Traktatin e Atlantikut të Veriut, tashmë ka paraqitur një tekst të pranuar që është bashkëngjitur, dhe

duke mirëpritur iniciativën e Shteteve të Bashkuara në propozimin e Marrëveshjes,

aprovon projekttekstin e Marrëveshjes, dhe

u rekomandon qeverive anëtare që ato të veprojnë në pajtim me kërkesat e tyre kombëtare me qëllim lidhjen e Marrëveshjes."

4. Hapi i dytë do të ishte që çdo shtet ta nënshkruajë atë sipas kushteve të kërkesave të tij kushtetuese. Kjo, në rastin e disa shteteve, mund të kërkojë sigurimin e Përfaqësuesve të Përhershëm përkatës të "Plotfuqisë". Delegacioni i Shteteve të Bashkuara i ka shpjeguar grupit të punës që proceset e veta të brendshme do të lehtësoheshin së tepërmi nëse nënshkrimet do të viheshin në Marrëveshje menjëherë sapo secili shtet i veçantë të ishte gati për ta bërë këtë sesa të priste deri sa shteti i fundit të jetë në gjendje për ta nënshkruar dhe pastaj të gjithë ta nënshkruajnë njëkohësisht. Grupi i punës rekomandon në mënyrë unanime që procedura e sugjeruar nga Shtetet e Bashkuara duhet të miratohet. Kjo pikëpamje është e pasqyruar në nenin 12 të tekstit të vetë Marrëveshjes.

5. Së treti, secili shtet, në pajtim me procedurat e veta kushtetuese, e ratifikon këtë Marrëveshje, që do të hynte në fuqi pasi këtë ta ketë bërë secili shtet.

6. Si në rastin e marrëveshjes së mëparshme, sugjerohet që Marrëveshja e re duhet të deklasifikohet dhe t'i jepet shtypit. Kjo duhet të bëhet në një datë që vendoset nga Këshilli. Megjithatë, të dy anekset duhet të ruajnë klasifikimin e tyre të tashme, dhe natyrisht nuk do t'i jepen shtypit.

7. Së fundi, Marrëveshja, sipas dispozitave të nenit 102 të Kartës së Kombeve të Bashkuara, duhet t'i komunikohet Organizatës.

8. Rekomandohet që Këshilli duhet të:

a) miratojë një rezolutë të parashikuar në paragrafin 3 më sipër;

b) bien dakord mbi procedurën për nënshkrim dhe ratifikim, të parashikuar në paragrafët 4 dhe 5 më sipër;

c) bien dakord që Marrëveshja duhet të jetë e hapur për nënshkrim dyzet e tetë orë pasi të gjitha delegacionet të jenë njoftuar për konfirmimin përfundimtar të pranimit të rezolutës së paragrafit 3 më sipër nga të gjitha shtetet anëtare;

d) vendosin mbi kohën e deklasifikimit dhe publikimit për shtyp të vetë Marrëveshjes.

(Nënshkruar) Colderidge
Kryetar
OTAN/NATO Paris, XVIe

MARRËVESHJE
NDËRMJET PALËVE NË TRAKTATIN E ATLANTIKUT TË VERIUT PËR BASHKËPUNIMIN NË LIDHJE ME INFORMACIONIN ATOMIK

PREAMBUL

Palët e Traktatit të Atlantikut të Veriut, të nënshkruar në Uashington më 4 prill 1949,

duke ditur që siguria dhe mbrojtja e tyre e përbashkët kërkon që ata të jenë të përgatitura të përballojnë situatat e mundshme të luftës atomike;

duke ditur që interesat e tyre të përbashkëta do të përparojnë duke i dhënë Organizatës së Traktatit të Atlantikut të Veriut dhe shteteve të saj anëtare informacion që u përket atyre;

duke marrë parasysh Aktin e Energjisë Atomike të Shteteve të Bashkuara të vitit 1954, i ndryshuar, që u përgatit duke pasur parasysh këto qëllime;

duke vepruar në emër të tyre dhe në emër të Organizatës së Traktatit të Atlantikut të Veriut,

bien dakord si më poshtë:

Neni 1

Në pajtim dhe në përmbushje të kërkesave të Aktit të Energjisë Atomike të Shteteve të Bashkuara të vitit 1954, i ndryshuar, Qeveria e Shteteve të Bashkuara të Amerikës, ndërsa Organizata e Traktatit të Atlantikut të Veriut vazhdon të japë kontribute thelbësore dhe materiale për mbrojtjen dhe sigurinë e përbashkët, do të bashkëpunojë duke i komunikuar herë pas here Organizatës së Traktatit të Atlantikut të Veriut dhe shteteve të saj anëtare, ndërsa këta vazhdojnë t'i japin këto kontribute, informacion atomik, në pajtim me dispozitat e kësaj Marrëveshjeje, me kusht që Qeveria e Shteteve të Bashkuara të Amerikës të përcaktojë se ky bashkëpunim do të nxisë dhe nuk do të përbëjë një rrezik të paarsyeshëm për mbrojtjen dhe sigurinë e saj.

Neni 2

Duke ndjekur detyrimin e Qeverisë së Shteteve të Bashkuara të Amerikës sipas kësaj Marrëveshjeje, shtetet e tjera, anëtare të Organizatës së Traktatit të Atlantikut të Veriut, në masën që ata e konsiderojnë të nevojshme, i komunikojnë Organizatës së Traktatit të Atlantikut të Veriut, duke përfshirë elementet e saj ushtarake dhe civile, dhe shteteve anëtare informacion atomik që buron prej tyre për të njëjtat lloje që parashikohen në këtë Marrëveshje. Termat dhe kushtet që rregullojnë këto komunikime të shteteve të tjera anëtare janë objekt i marrëveshjeve të tjera, por do të jenë të njëjta ose të ngjashme me termat dhe kushtet e përcaktuara në këtë Marrëveshje.

Neni 3

Qeveria e Shteteve të Bashkuara të Amerikës i komunikon Organizatës së Traktatit të Atlantikut të Veriut, duke përfshirë elementet e saj ushtarake dhe civile, dhe shteteve anëtare të Organizatës së Traktatit të Atlantikut të Veriut që kërkojnë informacion atomik në lidhje me funksionet e tyre për sa u takon misioneve të NATO-s, ku ky informacion atomik përcaktohet nga Qeveria e Shteteve të Bashkuara të Amerikës si i nevojshëm për:

a) zhvillimin e planeve të mbrojtjes;

b) trajnimin e personelit në aplikimin dhe mbrojtjen nga armët atomike dhe aplikimet e tjera ushtarake të energjisë atomike;

c) vlerësimin e aftësive të armiqve të mundshëm në përdorimin e armëve atomike dhe aplikimeve të tjera ushtarake të energjisë atomike;

d) zhvillimin e sistemeve të shpërndarjes të përshtatshme për armët atomike që ata kanë.

Neni 4

1. Bashkëpunimi sipas kësaj Marrëveshjeje do të kryhet nga Qeveria e Shteteve të Bashkuara të Amerikës, në pajtim me ligjet e saj të zbatueshme.

2. Sipas kësaj Marrëveshjeje, nuk do të ketë transferime nga Qeveria e Shteteve të Bashkuara të Amerikës të armëve atomike, pjesëve jobërthamore të armëve atomike, ose pjesëve jobërthamore të sistemeve të armëve atomike që kanë të dhëna të kufizuara.

3. Informacioni atomik që komunikohet nga Qeveria e Shteteve të Bashkuara, në pajtim me këtë Marrëveshje, përdoret ekskluzivisht për përgatitjen ose zbatimin e planeve dhe aktiviteteve të NATO-s për mbrojtjen dhe zhvillimin e sistemeve të shpërndarjes në interes të përbashkët të Organizatës së Traktatit të Atlantikut të Veriut.

Neni 5

1. Informacionit atomik të komunikuar në pajtim me këtë Marrëveshje i jepet mbrojtje e plotë e sigurisë sipas rregulloreve dhe procedurave të zbatueshme të NATO-s, masave të miratuara për sigurinë, legjislacionit dhe rregulloret e brendshme. Në asnjë rast Organizata e Traktatit të Atlantikut të Veriut apo shtetet e saj anëtare nuk mbajnë standarde sigurie për garantimin e

informacionit atomik më pak të kufizuar se ato të parashikuara në rregulloret përkatëse të NATO-s për sigurinë dhe masat e tjera të miratuara për sigurinë në fuqi në datën që kjo Marrëveshje hyn në fuqi.

2. Vendosja dhe bashkërendimi i programit të sigurisë në të gjitha elementet ushtarake dhe civile të NATO-s realizohet nën autoritetin e Këshillit të Atlantikut të Veriut, në pajtim me procedurat e parashikuara në masat e miratuara për sigurinë.

3. Informacioni atomik i komunikuar nga Qeveria e Shteteve të Bashkuara të Amerikës, në pajtim me këtë Marrëveshje, ofrohet nëpërmjet kanaleve të komunikimit të informacionit atomik që ekziston tashmë ose që miratohet më vonë.

4. Informacioni atomik i komunikuar ose shkëmbyer, në pajtim me këtë Marrëveshje, nuk i komunikohet ose shkëmbehet nga Organizata e Traktatit të Atlantikut të Veriut ose persona nën juridiksionin e saj me asnjë person të paautorizuar ose, përveç kur parashikohet në paragrafin 5 të këtij neni, përtej juridiksionit të asaj Organizate.

5. Përveç kur përcaktohet ndryshe nga Qeveria e Shteteve të Bashkuara të Amerikës, informacioni atomik i Shteteve të Bashkuara i dhënë Organizatës së Traktatit të Atlantikut të Veriut mund t'u komunikohet nga Organizata e Traktatit të Atlantikut të Veriut shteteve të saj anëtare sipas nevojës për të përmbushur funksionet në lidhje me misionet e NATO-s, me kusht që shpërndarja e këtij informacioni atomik brenda këtyre shteteve anëtare të jetë i kufizuar tek ata individë të veçantë që kanë të bëjnë me misionet e NATO-s për të cilat kërkohet informacioni. Shtetet anëtare bien dakord që informacioni atomik i marrë në këtë mënyrë nga Organizata e Traktatit të Atlantikut të Veriut ose ndryshe në pajtim me këtë Marrëveshje nuk u transferohet personave të paautorizuar ose përtej juridiksionit të shtetit anëtar marrës; megjithatë, ky informacion mund t'i komunikohet Organizatës së Traktatit të Atlantikut të Veriut ose, kur autorizohet nga Qeveria e Shteteve të Bashkuara të Amerikës, shteteve të tjera anëtare që kërkojnë informacionin për funksionet në lidhje me misionet e NATO-s.

Neni 6

Pavarësisht dispozitave të tjera të kësaj Marrëveshjeje, Qeveria e Shteteve të Bashkuara të Amerikës mund të vendosë shkallën në të cilën një informacion atomik i dhënë prej saj Organizatës së Traktatit të Atlantikut të Veriut ose shteteve anëtare mund të shpërndahet; mund të përcaktojë kategoritë e personave që kanë akses te ky informacion, dhe mund të vendosë kufizime të tjera mbi shpërndarjen e informacionit që ajo i konsideron të nevojshme.

Neni 7

1. Një palë që merr informacion atomik sipas kësaj Marrëveshjeje, e përdor atë vetëm për qëllimet e specifikuara në të. Çdo shpikje ose zbulim që rrjedh nga zotërimi i këtij informacioni nga ana e një pale marrëse ose personi nën juridiksionin e saj i ofrohet falas Qeverisë së Shteteve të Bashkuara të Amerikës për qëllime mbrojtjeje në pajtim me ato masa që mund të bihen dakord dhe garantohen në pajtim me dispozitat e nenit V të kësaj Marrëveshjeje.

2. Zbatimi ose përdorimi i çdo informacioni të komunikuar sipas kësaj marrëveshjeje, është përgjegjësi e palës që e merr atë; pala që komunikon informacionin nuk jep asnjë kompensim apo garanci në lidhje me zbatimin apo përdorimin e tij.

Neni 8

Asgjë në këtë Marrëveshje nuk konsiderohet sikur zëvendëson ose ndikon ndryshe në marrëveshjet dypalëshe ndërmjet palëve të kësaj Marrëveshjeje që parashikon bashkëpunim në shkëmbimin e informacionit atomik.

Neni 9

Për qëllimet e kësaj Marrëveshjeje:

a) "Armë atomike" është çdo mjet që përdor energjinë atomike, përveç pajisjes së transportit ose drejtimit të mjetit (nëse kjo pajisje është pjesë e ndashme e mjetit), qëllimi kryesor i së cilës është përdorimi ose zhvillimi i një arme, prototipi arme ose një mjeti prove për armët.

b) "Informacion atomik" që jepet nga Qeveria e Shteteve të Bashkuara, sipas kësaj Marrëveshjeje, është informacioni që është përcaktuar "Të dhëna të kufizuara" ose "Të dhëna të kufizuara më parë" nga Qeveria e Shteteve të Bashkuara të Amerikës.

Neni 10

1. Kjo Marrëveshje hyn në fuqi me marrjen nga Qeveria e Shteteve të Bashkuara të Amerikës të njoftimit nga të gjitha palët në Traktatin e Atlantikut të Veriut që ato dëshirojnë të respektojnë termat e Marrëveshjes.

2. Kjo Marrëveshje mbetet në fuqi deri sa të përfundohet me marrëveshje unanime apo të zëvendësohet nga një marrëveshje tjetër, ku është e kuptueshme, sidoqoftë, që përfundimi i kësaj Marrëveshjeje si e tërë nuk i liron palët nga kërkesat e kësaj Marrëveshjeje për të garantuar informacionin e ofruar në pajtim me të.

Neni 11

Pavarësisht dispozitave të nenit VI(4) të Marrëveshjes ndërmjet palëve në Traktatin e Atlantikut të Veriut për bashkëpunimin në lidhje me informacionin atomik, të nënshkruar në Paris më 22 qershor 1955, kjo Marrëveshje, me hyrjen e saj në fuqi, zëvendëson Marrëveshjen e sipërpërmendur, ku kuptohet që informacioni i dhënë, sipas asaj Marrëveshjeje, konsiderohet për të gjitha qëllimet të jetë komunikuar sipas dispozitave të kësaj Marrëveshjeje.

Neni 12

Kjo Marrëveshje ka datën në të cilën hapet për nënshkrim dhe mbetet e hapur për nënshkrim derisa të jetë nënshkruar nga të gjitha shtetet palë në Traktatin e Atlantikut të Veriut.

Në dëshmi të kësaj, përfaqësuesit e poshtëshënuar, e kanë nënshkruar këtë Marrëveshje në emër të shteteve të tyre përkatëse, anëtarëve të Organizatës së Traktatit të Atlantikut të Veriut, dhe në emër të Organizatës së Traktatit të Atlantikut të Veriut.

Bërë në Paris, në ditën e 18 të qershorit 1964, në gjuhën angleze dhe frënge, ku të dy tekstet janë njëlloj të barasvlershme, në një kopje të vetme origjinale, e cila depozitohet në arkivat e Qeverisë së Shteteve të Bashkuara të Amerikës.

Qeveria e Shteteve të Bashkuara të Amerikës transmeton kopje të vërtetuara të saj të gjitha shteteve nënshkruese dhe aderuese.

Për Mbretërinë e Belgjikës:
Për Kanadanë:
Për Mbretërinë e Danimarkës:
Për Francën:
Për Republikën Federale Gjermane:
Për Mbretërinë e Greqisë:
Për Islandën:
Për Italinë:
Për Dukatën e Madhe të Luksemburgut:
Për Mbretërinë e Holandës:
Për Mbretërinë e Norvegjisë:
Për Portugalinë:

Për Turqinë:
Për Mbretërinë e Bashkuar të Britanisë së Madhe dhe Irlandës së Veriut:
Për Shtetet e Bashkuara të Amerikës:

ANEKS TEKNIK PËR MARRËVESHJEN NDËRMJET PALËVE NË TRAKTATIN E ATLANTIKUT TË VERIUT PËR BASHKËPUNIMIN NË LIDHJE ME INFORMACIONIN ATOMIK

Dispozitat e këtij aneksi zbatojnë disa nga dispozitat e Marrëveshjes për bashkëpunim në lidhje me informacionin atomik të bërë në Paris, më 18 qershor 1964 (këtej e tutje referuar si Marrëveshja) pjesë integrale e së cilës është ky aneks.

SEKSIONI I

Sipas termave dhe kushteve të Marrëveshjes, tipet e informacionit atomik që Qeveria e Shteteve të Bashkuara mund t'i japë Organizatës së Traktatit të Atlantikut të Veriut dhe shteteve të asaj anëtare janë:

A. Siç mund të jetë e nevojshme për planifikimin e mbrojtjes së përbashkët, trajnimin dhe kërkesat për logjistikë, informacioni në lidhje me shifrat, vendndodhjet, tipet, kapacitetet, armatimi, sigurimin, komandën dhe kontrollin dhe detonuesit e atyre armëve atomike që mund të ofrohen për përdorim nga ose në mbështetje të Organizatës së Traktatit të Atlantikut të Veriut.

B. Efektet që priten ose rrjedhin nga detonimi i armëve atomike.

C. Reagimet e strukturave, pajisjeve, komunikimeve dhe personelit ndaj efekteve të armëve atomike, duke përfshirë kriteret e dëmeve dhe humbjeve në njerëz.

D. Metodat dhe procedurat për analizat në lidhje me efektet e armëve atomike.

E. Informacioni mbi aftësitë e shteteve armike potenciale për luftën atomike.

F. Informacioni mbi armët atomike dhe sistemet e armëve atomike që kërkohen për zotërimin e aftësisë së dorëzimit për armë të caktuara atomike që mund të ofrohen për përdorim nga ose në mbështetje të Organizatës së Traktatit të Atlantikut të Veriut, duke përfshirë informacionin e kërkuar për vlerësimin e sistemeve të armëve atomike për të përcaktuar kërkesat dhe strategjinë e NATO-s.

G. Informacioni në lidhje me sistemet e dorëzimit, duke përfshirë taktikat dhe teknikat dhe detyrat e mirëmbajtjes, montimit, personelit të dorëzimit dhe aktivizimit që kërkohen për zotërimin e aftësisë së dorëzimit të armëve të caktuara atomike.

H. Në masën që ato ndikojnë në planifikimin e NATO-s, rezultatet që priten nga ofensiva strategjike ajrore.

I. Informacioni i kërkuar për arritjen e përputhshmërisë së armëve të caktuara atomike me automjetet e përcaktuara të dorëzimit.

J. Tiparet e sigurisë së armëve të përcaktuara atomike dhe të sistemeve operative që shoqërojnë këto armë dhe informacioni i nevojshëm dhe i përshtatshëm për operacionet e shpëtimit dhe rikuperimit si pasojë e një aksidenti me armë.

K. Informacioni i kërkuar për planifikimin dhe trajnimin e personelit në përdorimin dhe mbrojtjen kundër armëve atomike dhe duke përfshirë informacionin në lidhje me:

1. Përdorimet ushtarake të izotopeve për qëllime mjekësore;

2. Mbrojtja kundër luftës radiologjike.

L. Informacion në lidhje me mbrojtjen civile kundër sulmeve atomike.

M. Informacioni tjetër që mund të përcaktohet nga Autoritetet e Shteteve të Bashkuara si i nevojshëm për mbështetjen e Organizatës së Traktatit të Atlantikut të Veriut dhe i transferueshëm sipas dispozitave të Aktit të Energjisë Atomike të vitit 1954, i ndryshuar, si dhe Marrëveshjes.

SEKSIONI II

Asnjë informacion mbi aplikimet e tjera ushtarake të energjisë atomike, reaktorëve ushtarakë, impiantet e drejtimit nuklear detar, nuk komunikohen në bazë të kësaj Marrëveshjeje.

Për Mbretërinë e Belgjikës:
Për Kanadanë:
Për Mbretërinë e Danimarkës:
Për Francën:
Për Republikën Federale Gjermane:
Për Mbretërinë e Greqisë:
Për Islandën:
Për Italinë:
Për Dukatën e Madhe të Luksemburgut:
Për Mbretërinë e Holandës:
Për Mbretërinë e Norvegjisë:
Për Portugalinë:
Për Turqinë:
Për Mbretërinë e Bashkuar të Britanisë së Madhe dhe Irlandës së Veriut:
Për Shtetet e Bashkuara të Amerikës:

ANEKS SIGURIE I MARRËVESHJES NDËRMJET PALËVE TË TRAKTATIT TË ATLANTIKUT TË VERIUT PËR BASHKËPUNIMIN NË LIDHJE ME INFORMACIONIN ATOMIK

Ky aneks parashikon masat e sigurisë që Organizata e Traktatit të Atlantikut të Veriut dhe shtetet anëtare zbatojnë për të garantuar informacionin atomik të dhënë nga Qeveria e Shteteve të Bashkuara të Amerikës Organizatës së Traktatit të Atlantikut të Veriut dhe shteteve të saj anëtare, në pajtim me Marrëveshjen për bashkëpunim në lidhje me informacionin atomik të bërë në Paris, më 18.6.1964 (këtej e tutje referuar si "Marrëveshja") pjesë integrale e së cilës është ky aneks. Në rast se një anëtar tjetër i Organizatës së Traktatit të Atlantikut të Veriut i ndryshëm nga Qeveria e Shteteve të Bashkuara të Amerikës jep një informacion atomik në pajtim me nenin II të Marrëveshjes, ky informacion garantohet nga masat e sigurisë jo më pak kufizuese se ato të parashikuara në këtë aneks.

SEKSIONI I
TË PËRGJITHSHME

A. Rregulloret e NATO-s për sigurinë, jo më pak kufizuese se ato që tashmë parashikohen në C-M(55)15(Përfundimtare) dhe shtojcën konfidenciale të 1 janarit 1961, si dhe masat e sigurisë të përcaktuara në këtë aneks, zbatohen nga elementet ushtarake dhe civile të NATO-s dhe nga shtetet anëtare të informacionit atomik që komunikohet në pajtim me këtë Marrëveshje.

B. Programet e sigurisë që zbatohen nga të gjitha elementet ushtarake dhe civile të NATO-s dhe nga shtetet anëtare që marrin informacion atomik, në pajtim me Marrëveshjen, parashikojnë plotësisht zbatimin e kërkesave për sigurinë të parashikuara në këtë aneks.

C. Sekretari i Përgjithshëm, duke vepruar në emër të Këshillit të Atlantikut të Veriut dhe nën autoritetin e tij, është përgjegjës për mbikëqyrjen e zbatimit të programit të NATO-s për sigurinë për mbrojtjen e informacionit atomik sipas kësaj Marrëveshjeje. Ai garanton me anë të procedurave të parashikuara në seksionin X të këtij aneksi që të gjitha masat e kërkuara nga programet e NATO-s për sigurinë të përfshihen në elementet civile dhe ushtarake të NATO-s dhe elementet civile dhe ushtarake kombëtare për të mbrojtur informacionin që shkëmbehet në bazë të Marrëveshjes.

D. Asnjë individ nuk ka të drejtë të hyjë në informacionin atomik vetëm për shkak të gradës, emërimit apo certifikatës së sigurisë.

E. Aksesi në informacionin atomik të dhënë Organizatës së Traktatit të Atlantikut të Veriut është i kufizuar për shtetasit e shteteve anëtare të Organizatës së Traktatit të Atlantikut të Veriut që u është dhënë certifikata e sigurisë, në pajtim me seksionin II të këtij aneksi dhe përgjegjësitë e të cilëve kërkojnë akses në informacion.

F. Aksesi në informacionin atomik që i është dhënë një shteti anëtar, në pajtim me Marrëveshjen, është i kufizuar te shtetasit e tij të cilëve u është dhënë certifikatë sigurie në pajtim me seksionin II të këtij aneksi dhe detyrat e të cilëve kërkojnë askses, me qëllim që shteti anëtar të përmbushë përgjegjësitë dhe detyrimet e tij ndaj Organizatës së Traktatit të Atlantikut të Veriut.

SEKSIONI II
SIGURIA E PERSONELIT

A. Asnjë individi nuk i jepet certifikatë sigurie për akses në informacionin atomik, përveç kur përcaktohet që kjo certifikatë nuk rrezikon sigurinë e Organizatës së Traktatit të Atlantikut të Veriut ose sigurinë kombëtare të shteteve anëtare të Organizatës së Traktatit të Atlantikut të Veriut.

B. Para dhënies së aksesit në informacionin atomik, përcaktimi i pranueshmërisë (vendimi për dhënien e certifikatës së sigurisë) për çdo individ për dhënien e këtij aksesi bëhet nga një autoritet përgjegjës i qeverisë së individit përkatës.

C. Vendimi nëse dhënia e një certifikate të sigurisë është qartësisht në pajtim me interesat e sigurisë përcaktohet në bazë të gjithë informacionit të dhënë. Para këtij përcaktimi, bëhet një hetim nga një autoritet përgjegjës i qeverisë dhe informacioni i mbledhur rishikohet duke marrë parasysh tipet kryesore të informacionit devijues që ngre dyshime në lidhje me pranueshmërinë e individit për certifikatën e sigurisë, siç janë parashikuar në seksionin III të shtojcës konfidenciale të datës 1 janar 1961, tek C-N(55)15(Përfundimtare).

D. Objekti dhe masa minimale e hetimit është në pajtim me standardet e parashikuara në seksionin II të shtojcës konfidenciale të C-N(55)15(Përfundimtare), përveç kur kërkohet një hetim të rrethanave për certifikatë për akses në informacionin atomik të klasifikuar Sekret për individët e ndryshëm nga anëtarët e Forcave të Armatosura ose personelin civil të strukturave ushtarake të shteteve anëtare.

E. Çdo strukturë që trajton informacion atomik mban një regjistër të përshtatshëm për certifikimin e individëve të autorizuar për të pasur akses në këtë informacion në strukturë. Çdo certifikatë rishikohet, sipas rastit, për të siguruar që ai është në pajtim me standardet e tashme të zbatueshme për përfshirjen e individit, dhe rishqyrtohet si prioritet kur merret informacioni që tregon se vazhdimi i përfshirjes me akses në informacionin atomik nuk mund të jetë më në pajtim me interesat e sigurisë.

F. Ndërlidhja efektive mbahet në çdo shtet ndërmjet agjencive kombëtare përgjegjëse për sigurinë kombëtare dhe autoritetit përgjegjës për marrjen e vendimeve për certifikatat për të siguruar njoftim të menjëhershëm të informacionit me implikime devijuese që zhvillohet pas dhënies së certifikatës së sigurisë.

SEKSIONI III
SIGURIA FIZIKE

A. Informacioni atomik mbrohet fizikisht kundrejt spiunazhit, sabotimit, aksesit të paautorizuar ose çdo aktivitet tjetër armiqësor. Kjo mbrojtje bëhet në përputhje me rëndësinë e interesit përkatës të sigurisë.

B. Programet për sigurinë fizike të informacionit atomik përpilohen për të siguruar:

1. Mbrojtje të përshtatshme të informacionit atomik të disponueshëm për përdorim të menjëhershëm, në ruajtje ose tranzit.

2. Krijimi i zonave të sigurisë me akses të kontrolluar, kur konsiderohen të nevojshme për shkak të ndjeshmërisë, karakterit, volumit dhe përdorimit të informacionit të klasifikuar atomik dhe karakterit dhe vendndodhjes së ndërtesës apo të ndërtesave përkatëse.

3. Një sistem me akses së kontrolluar që përfshin procedurat për një autoritet kompetent për të autorizuar aksesin, metoda të sakta të identifikimit të personelit dhe përgjegjshmërinë për mjete të identifikimit; dhe një mjet për zbatimin e kufizimeve të lëvizjes brenda dhe aksesit në zonat e sigurisë.

C. Dispozitat e paragrafëve B më sipër do të jenë shtesë e procedurave të parashikuara në seksionin IV të C-M(55)15(Përfundimtare).

SEKSIONI IV
KONTROLLI I INFORMACIONIT ATOMIK

A. Mbahen programet e kontrollit të informacionit që kanë si qëllime të tyre kryesore:

1. Kontrollin e aksesit;

2. Përgjegjshmëri e gatshme, në përputhje me shkallën e ndjeshmërisë.

3. Asgjësim nëse nuk vazhdon të nevojitet.

B. Klasifikimet e sigurisë të zbatuara nga Qeveria e Shteteve të Bashkuara për informacionin atomik të komunikuar sipas Marrëveshjes respektohen përgjithmonë; rikategorizimi ose deklasifikimi mund të bëhet vetëm me aprovimin e Qeverisë së Shteteve të Bashkuara të Amerikës.

C. Dokumentet që përmbajnë informacion atomik të Shteteve të Bashkuara, të komunikuar sipas kësaj Marrëveshjeje, mbajnë shënimet e NATO-s dhe një klasifikim sigurie të barasvlershëm me atë që caktohet nga Qeveria e Shteteve të Bashkuara të Amerikës, që pasohet nga fjala ATOMAL. Përveç kësaj, shënimi i mëposhtëm futet në dokument në gjuhën e dokumentit:

"Ky dokument përmban informacion atomik të Shteteve të Bashkuara (Të dhëna të kufizuara ose të dhëna të kufizuara më parë) të dhënë në bazë të Marrëveshjes së NATO-s për bashkëpunimin në lidhje me informacionin atomik, të nënshkruar nga 18 qershor 1964 dhe garantohet përkatësisht."

D. Të dhënat e përgjegjshmërisë mbahen për të gjitha dokumentet Tepër Sekret dhe Sekret dhe për të gjitha dokumentet për të cilat kufizimet e veçanta janë vendosura në pajtim me nenin VI të Marrëveshjes. Këto të dhëna tregojnë identitetin e të gjithë marrësve të dokumenteve mbi të cilat janë vendosur kufizime të veçanta.

E. Riprodhimi, duke përfshirë ekstraktet dhe përkthimet, e dokumenteve që përmbajnë informacion atomik të Shteteve të Bashkuara që kanë shënimet e specifikuara në paragrafin C më sipër mund të bëhen sipas rregullave të mëposhtme:

1. Dokumentet e klasifikuara Sekret dhe Tepër Sekret mund të riprodhohen vetëm me aprovimin paraprak të Qeverisë së Shteteve të Bashkuara të Amerikës. Këto dokumente kanë një shënim të përshtatshëm për këtë qëllim. Në situata emergjence, nëse aprovimi paraprak nuk mund të merret në kohë, mund të hiqet dorë nga ky rregull, por Qeveria e Shteteve të Bashkuara të Amerikës informohet për këtë me anë të mjeteve më të shpejta.

2 Dokumentet e klasifikuara Konfidenciale mund të riprodhohen vetëm nëse është e nevojshme për të përmbushur kërkesat faktike.

3. Riprodhimet, duke përfshirë ekstraktet dhe përkthimet, mbajnë të gjitha shënimet e sigurisë (duke përfshirë shënimin e përshkruar në paragrafin C) të gjetura në dokumentin origjinal dhe vendosen nën kontrollet e përgjegjshmërisë që zbatohen për dokumentet origjinale. Nëse paragrafët kanë klasifikime të ndara, klasifikimi i sigurisë së dokumenteve që kanë informacion atomik të nxjerrë mban klasifikimin e paragrafit me klasifikimin më të lartë nga i cili janë nxjerrë ekstraktet dhe, sipas rastit, shënimin e përcaktuar në paragrafin C. Kontrollet e përgjegjshmërisë për informacionin atomik të nxjerrë janë sipas parashikimit në paragrafin D të këtij seksioni. Për më tepër, ato kufizime të veçanta që mund të jenë vendosur në dokumentin origjinal zbatohen edhe për dokumentet që përmbajnë ekstraktet.

F. Dokumentet e përgatitura për të regjistruar informacionin atomik të marrë sipas Marrëveshjes me mjete verbale apo vizuale kanë shënimet e përcaktuara në paragrafin C më sipër dhe u nënshtrohen rregullave për përgjegjshmërinë dhe kontrollin e zbatueshëm për nivelin e klasifikimit përkatës.

SEKSIONI V
KANALET E TRANSMETIMIT

Komunikimet e Qeverisë së Shteteve të Bashkuara të Amerikës të informacionit atomik sipas Marrëveshjes, duke përfshirë komunikimet verbale dhe vizuale, bëhen nëpërmjet kanaleve që ekzistojnë ose që mund të miratohen më vonë. Për të asistuar Sekretarin e Përgjithshëm për përmbushjen e përgjegjësive të tij për sigurinë sipas paragrafit C të seksionit I të këtij aneksi, Qeveria e Shteteve të Bashkuara të Amerikës i jep Sekretarit të Përgjithshëm informacion të plotë për të identifikuar çdo komunikim me shkrim të informacionit atomik nga Qeveria e Shteteve të Bashkuara të Amerikës dhe çdo komunikim të autorizuar nga Qeveria e Shteteve të Bashkuara të Amerikës sipas kësaj Marrëveshjeje. Ky informacion do të dërgohet gjithashtu te Grupi i Përhershëm për të gjitha komunikimet e bëra për elementet ushtarake.

SEKSIONI VI
RAPORTET

A. Çdo shtet anëtar dhe element ushtarak dhe civil i NATO-s që merr informacion atomik të Shteteve të Bashkuara sipas Marrëveshjes i paraqet brenda 31 marsit të çdo viti duke përdorur kanalet që ekzistojnë ose që mund të miratohen më vonë, nëpërmjet Sekretarit të Përgjithshëm Qeverisë së Shteteve të Bashkuara të Amerikës një raport që përmban sa më poshtë:

1. Një listë të të gjitha dokumenteve atomike të marrë nga Qeveria e Shteteve të Bashkuara të Amerikës gjatë dymbëdhjetë muajve që mbarojnë më 31 dhjetor të vitit të kaluar.

2. Një të dhënë të shpërndarjes së dokumenteve të renditura në paragrafin 1 të mësipërm, dhe

3. Një vërtetim që është bërë një listë fizike e të gjitha dokumenteve atomike për të cilat shteti anëtar ose elementi ushtarak ose civil i NATO-s është përgjegjës sipas Marrëveshjes. Vërtetimi përfshin një listë të të gjitha dokumenteve të papërfshira, me një deklarim për rezultatet e hetimit të humbjes dhe masat korrigjuese të marra për të penguar përsëritjen.

B. Nëse informacioni atomik i Shteteve të Bashkuara i komunikuar sipas Marrëveshjes kompromethohet me humbjen e dokumenteve ose ndonjë mjet tjetër, një raport i menjëhershëm që përfshin të gjithë informacionin përkatës, në lidhje me kompromethimin, duke përdorur kanalet ekzistuese ose që mund të miratohen më vonë, i bëhet Sekretarit të Përgjithshëm dhe Qeverisë së Shteteve të Bashkuara të Amerikës.

SEKSIONI VII
EDUKIMI I SIGURISË

Shtetet anëtare dhe elementet ushtarake dhe civile të NATO-s që marrin informacion sipas Marrëveshjes mbajnë një program të përshtatshëm për të siguruar që të gjithë individët, të cilëve u autorizohet akses në informacionin atomik të informohen për përgjegjësitë e tyre për garantimin e atij informacioni. Programi përfshin një sugjerim dhe orientim fillestar specifik periodik, ritheksim periodik të përgjegjësive individuale dhe një intervistë përmbyllëse që thekson përgjegjësitë në vazhdim për mbrojtjen e informacionit atomik.

SEKSIONI VIII
SIGURIA E KONTRATAVE TË KLASIFIKUARA

Çdo kontratë e klasifikuar, nënkontratë, marrëveshje konsulence ose masë tjetër e marrë përsipër nga palët në Marrëveshje, përmbushja e të cilave ka të bëjë me aksesin në informacionin atomik të shkëmbyer sipas kësaj Marrëveshjeje, përmban dispozita përkatëse që vendosin detyrime mbi palët private të përfshira për të respektuar masat e sigurisë të parashikuara në këtë aneks.

SEKSIONI IX
RISHIKIMI I VAZHDUESHËM I SISTEMIT TË SIGURISË

A. Njihet që zbatimi efektiv dhe i menjëhershëm i politikave të sigurisë mund të përparohet materialisht nëpërmjet vizitave reciproke të personelit të sigurisë. Është rënë dakord të vazhdohet me një shkëmbim të hollësishëm të mendimeve në lidhje me politikat, standardet dhe procedurat e sigurisë, dhe t'u lejohet grupeve të punës të sigurisë të Shteteve të Bashkuara të shqyrtojnë dhe të shohin drejtpërdrejt procedurat dhe praktikat e agjencive të Organizatës së Traktatit të Atlantikut të Veriut dhe të agjencive të shteteve anëtare përgjegjëse për mbrojtjen e dokumenteve dhe informacionit të komunikuar sipas Marrëveshjes, këto vizita ndërmerren me qëllim arritjen e një marrëveshjeje mbi përshtatshmërinë dhe krahasueshmërinë e arsyeshme të sistemeve përkatëse të sigurisë.

B. Sekretari i Përgjithshëm dhe Grupi i Përhershëm në rastin e vizitave në elementet ushtarake, do të informohet për këto vizita dhe do t'i jepen raporte që parashtrojnë konstatimet përkatëse të grupeve të punës së Shteteve të Bashkuara pas çdo vizite. Të gjitha vizitat tek elementet kombëtare do të kryhen në pajtim me autoritetet e sigurisë kombëtare të shteteve përkatëse.

SEKSIONI X
INSPEKTIMET E SIGURISË

A. Inspektimi gjithëpërfshirës i sigurisë i të gjitha elementeve civile dhe ushtarake të NATO-s dhe shteteve anëtare që kanë marrë informacion atomik, sipas Marrëveshjes, bëhet rregullisht, por jo më pak se një herë çdo dymbëdhjetë muaj, në pajtim me kriteret e parashikuara në seksionin I, paragrafi A i këtij aneksi. Këto inspektime bëhen nga agjencitë e NATO-s që kanë përgjegjësinë për zbatimin e programeve të sigurisë së NATO-s, duke përdorur personel të kualifikuar. Këshilli, nëse e gjykon të nevojshme dhe të përshtatshme, mund të drejtojë kryerjen e inspektimeve të veçanta dhe të emërojë ekipet *ad hoc* të inspektimeve që përbëhet nga personeli i agjencive civile dhe ushtarake të NATO-s ose personel tjetër i kualifikuar. Vizitat në elementet ushtarake dhe civile të shteteve anëtare bashkërendohen me autoritetet përkatëse kombëtare.

B. Të gjitha fazat e programit të sigurisë shqyrtohen dhe brenda tridhjetë ditëve pas përfundimit të inspektimit, një raport me shkrim që përshin një listë të çdo mangësie të gjetur në zbatimin e rregulloreve të sigurisë i dërgohet Sekretarit të Përgjithshëm.

C. Kopje të këtyre raporteve të inspektimeve i ofrohen nga Sekretari i Përgjithshëm Shteteve të Bashkuara në pajtim me Marrëveshjen dhe, në pajtim me dispozitat e tjera të saj dhe sipas rastit, njësisë së inspektuar, autoritetit përkatës kombëtar të sigurisë dhe selisë ushtarake.

D. Brenda tridhjetë ditëve pas marrjes së raportit të inspektimit, autoritetet përkatëse të NATO-s ose elementit kombëtar të inspektuar i dërgojnë Sekretarit të Përgjithshëm një raport për veprimet e mara për të korrigjuar të gjitha mangësitë e renditura në raportin e inspektimit. Pas rishikimit të raporteve të inspektimit dhe raporteve për veprime korrigjuese të ndërmarra, Sekretari i Përgjithshëm, duke vepruar në emër të këshillit, sipas rastit, tërheq vëmendjen e autoriteteve kombëtare, Grupit të Përhershëm ose elementit civil përkatës për çdo veprim tjetër që kërkohet për të përmbushur kriteret e sigurisë së NATO-s dhe dispozitat e kësaj Marrëveshjeje. Kopje të raporteve të veprimit korrigjues, si dhe kopje të çdo komenti që vjen nga Sekretari i Përgjithshëm në pajtim me këtë paragraf shpërndahet në të njëjtën mënyrë siç parashikohet në paragrafin C të këtij seksioni për raportet e inspektimit.

E. Në rast se një problem në lidhje me veprimin korrigjues që lind nga një inspektim sigurie mbetet i pazgjidhur pas zbatimit të procedurës së parashikuar në paragrafin D të këtij seksioni, Sekretari i Përgjithshëm e sjell çështjen në vëmendje të Këshillit me rekomandimin që një ekip *ad hoc* inspektimi të caktohet për të hetuar problemin dhe për t'i raportuar Këshillit, i cili pas kësaj ndërmerr veprimin e përshtatshëm.

Për Mbretërinë e Belgjikës:
Për Kanadanë:
Për Mbretërinë e Danimarkës:
Për Francën:
Për Republikën Federale Gjermane:
Për Mbretërinë e Greqisë:
Për Islandën:
Për Italinë:
Për Dukatën e Madhe të Luksemburgut:
Për Mbretërinë e Holandës:
Për Mbretërinë e Norvegjisë:
Për Portugalinë:
Për Turqinë:
Për Mbretërinë e Bashkuar të Britanisë së Madhe dhe Irlandës së Veriut:
Për Shtetet e Bashkuara të Amerikës:

VENDIM
Nr.47, datë 22.7.2010

PËR EMËRIMIN E NJË ANËTARI TË BORDIT TË INSTITUTIT TË STUDIMEVE PËR KRIMET DHE PASOJAT E KOMUNIZMIT NË SHQIPËRI

Në mbështetje të nenit 78 të Kushtetutës, të nenit 8 të ligjit nr. 10 242, datë 25.2.2010 "Për Institutin e Studimeve për Krimet dhe Pasojat e Komunizmit në Shqipëri" dhe të nenit 111 të Rregullores së Kuvendit,

KUVENDI
I REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË

VENDOSI:

I. Zoti Uran Butka emërohet anëtar i Bordit të Institutit të Studimeve për Krimet dhe Pasojat e Komunizmit në Shqipëri.

II. Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

KRYETARE
Jozefina Topalli (Çoba)

VENDIM
Nr.48, datë 22.7.2010

PËR EMËRIMIN E NJË ANËTARI TË BORDIT TË INSTITUTIT TË STUDIMEVE PËR KRIMET DHE PASOJAT E KOMUNIZMIT NË SHQIPËRI

Në mbështetje të nenit 78 të Kushtetutës, të nenit 8 të ligjit nr. 10 242, datë 25.2.2010 "Për Institutin e Studimeve për Krimet dhe Pasojat e Komunizmit në Shqipëri" dhe të nenit 111 të Rregullores së Kuvendit,

KUVENDI
I REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË

VENDOSI:

I. Zoti Pjetër Pepa emërohet anëtar i Bordit të Institutit të Studimeve për Krimet dhe Pasojat e Komunizmit në Shqipëri.

II. Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

KRYETARE
Jozefina Topalli (Çoba)

VENDIM
Nr.49, datë 22.7.2010

PËR EMËRIMIN E NJË ANËTARI TË BORDIT TË INSTITUTIT TË STUDIMEVE PËR KRIMET DHE PASOJAT E KOMUNIZMIT NË SHQIPËRI

Në mbështetje të nenit 78 të Kushtetutës, të nenit 8 të ligjit nr. 10 242, datë 25.2.2010 "Për Institutin e Studimeve për Krimet dhe Pasojat e Komunizmit në Shqipëri" dhe të nenit 111 të Rregullores së Kuvendit,

KUVENDI
I REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË

VENDOSI:

I. Zoti Gëzim Peshkëpia emërohet anëtar i Bordit të Institutit të Studimeve për Krimet dhe Pasojat e Komunizmit në Shqipëri.

II. Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

KRYETARE
Jozefina Topalli (Çoba)

VENDIM
Nr.50, datë 22.7.2010

PËR EMËRIMIN E NJË ANËTARI TË BORDIT TË INSTITUTIT TË STUDIMEVE PËR KRIMET DHE PASOJAT E KOMUNIZMIT NË SHQIPËRI

Në mbështetje të nenit 78 të Kushtetutës, të nenit 8 të ligjit nr. 10 242, datë 25.2.2010 "Për Institutin e Studimeve për Krimet dhe Pasojat e Komunizmit në Shqipëri" dhe të nenit 111 të Rregullores së Kuvendit,

KUVENDI
I REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË

VENDOSI:

I. Zoti Kolec Topalli emërohet anëtar i Bordit të Institutit të Studimeve për Krimet dhe Pasojat e Komunizmit në Shqipëri.

II. Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

KRYETARE
Jozefina Topalli (Çoba)

Abonimet vjetore për Fletoren Zyrtare mund të bëhen pranë Postës Shqiptare ose pranë Qendrës së Publikimeve Zyrtare, në adresën: Bulevardi "Gjergj Fishta", mbrapa ish-ekspozitës "Shqipëria Sot", tel: 04 24 27 003.
Çmimi i abonimit në postë për Fletoret Zyrtare 2010 është 16 000 lekë.
Çmimi i abonimit në QPZ është 14 000 lekë pa detyrimin e shpërndarjes në adresa.

BOTIMET E QENDRËS SË PUBLIKIMEVE ZYRTARE

KODI PENAL	226 lekë
KODI I PROCEDURËS PENALE.....	330 lekë
KUSHTETUTA	95 lekë
PËRMBLEDHJE PËR KTHIMIN DHE KOMPENSIMIN E PRONAVE	140 lekë

Hyri në shtyp më 4.8.2010
Doli nga shtypi më 6.8.2010

Tirazhi: 2300 copë	Formati: 61x86/8

Shtypshkronja e Qendrës së Publikimeve Zyrtare
Tiranë, 2010

Çmimi 38 lekë